



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar". *(komision përgjegjës)*

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar" *(komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Florjon Mima, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Tatjana Nurçe, Lorenc Luka, Edmond Leka, Vullnet Sinaj, Edmond Spaho, Aldo Bumçi, Ervin Salianji, Klevis Balliu dhe Agron Shehaj.

Mungojnë:

Eglantina Gjermani, Dritan Bici, Robert Bitri, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Elira Kokona - Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë,

Oltjon Muzaka - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës

Ergys Qirici - Drejtor i Përgjithshëm i Pronës Publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Agron Hysenlliu - drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Ndërtimit

Kreshnik Merxhani - arkitekt i fokusuar në fushën e restaurimeve.

Adriatik Lapaj - avokat, aktivist i shoqërisë civile, mbështetës i aktorëve dhe i artistëve

Adriana Tolka - aktore në teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”,
përfaqësueses e Sindikatës së artistëve të skenës e të ekranit

Robert Budina - Robert Budina, regjisor dhe përfaqësues i Sindikatës së artistëve të
skenës e të ekranit

Gjergji Bojaxhi - përfaqësues i Forumit për trashëgiminë kulturore.

Dëshira Mena - arkitekte

Bruno Shllaku - aktor dhe regjisor i teatrit “Migjeni”, Shkodër.

Ervin Baçi - arkitekt

Neritan Liçaj - aktor i Teatrit Kombëtar.

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Pas një debati, le të themi, intensiv, të gjatë e të gjerë, sot jemi në diskutimet finale të projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

Sot kemi një dëgjesë me grupet e interesit. Ka disa grupe të propozuara nga institucione të ndryshme. Ndër ta ka arkitektë e individë, të cilët kanë shkruar në e-mailin e parlamentit. Është edhe grupi që keni propozuar ju, zoti Mima.

Pra, komisionin e keni të hapur për të dëgjuar, pavarësisht pozicioneve publike, me të cilat ne jemi njohur edhe në seancat e mëparshme.

Ne jemi komision përgjegjës, dhe si komision përgjegjës na duhet të presim dhe konkluzionet e komisioneve të tjera. Një komision e ka mbyllur veprimtarinë, që është Komisioni i Ligjeve, dhe relacioni i tyre ka ardhur. Ndërkohë, është duke u zhvilluar Komisioni i Medies. Besoj se edhe ata janë në finale.

Do të vijojmë dëgjesën me grupet e interesit. Unë kam një listë. Nuk jam i sigurtë nëse të gjithë personat që janë të regjistruar dhe kanë shprehur dëshirën për të marrë pjesë në këtë dëgjesë, janë të pranishëm.

Pra, mbledhjen e sotme do ta ndajmë në dy pjesë: pjesa e parë ka të bëjë me dëgjesën e të ftuarve, të cilëve, pa i përmendur emër për emër, po u uroj mirëseardhjen në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, të Tregtisë e të Mjedisit.

Në pjesën e dytë, mbasi t’i përcjellim aktorët, arkitektët, specialistët e fushave të ndryshme, do të vijojmë me diskutimin nën për nën të projektligjit, për të cilin ka edhe disa propozime për rregullime e axhustime.

Unë mendoj të japim një minutazh të caktuar. Çështja ka qenë publike. Ne jemi njohur me qëndrimet pro dhe kundër. Pra, mendoj t’i lëmë një minutazh personave që do të shprehen. Në fakt ne i kemi me grupe, por nuk e di nëse do të shprehen si grupe apo si individë.

Në rregull, si individë, por t’u lëmë një minutazh të caktuar, po themi tre, katër, pesë minuta. Në traditën tonë ka qenë pesë, por megjithatë, fjala juaj në komision, zoti Mima, është

më shumë se e mirëkuptueshme. Më pas, nëse do të ketë pyetje nga kolegët, mund t'u drejtohen pyetje. Pasi të përcjellim grupet e interesit, do të vijojmë me diskutimet nen për nen.

Dakord me rendin e ditës?

Ka ndonjë propozim? Nuk ka.

Para se t'u jap fjalën aktorëve, artistëve, arkitektëve e grupeve të interesit, dua të sjell në vëmendje, jo thjesht për të ftuarit, por edhe anëtarëve të komisionit, majtas apo djathtas qofshim, se jemi munduar të shmangim ato skena, për mua të neveritshme e të shëmtuara, që ditën e enjte i shohim shpesh, por që i kemi parë edhe në komisionet e tjera. Në këtë komision kemi krijuar një traditë, që edhe nëse kemi pikëpamje të kundërta apo krejtësisht të kundërta, në rastet më të shumta nuk kemi qenë të papëlqyeshëm për njëri-tjetrin.

E ritheksoj edhe sot: cilido që dëshiron të flasë, do të ngrejë dorën dhe do të marrë fjalën; nuk do t'i ndërpresim as ata që pyesin e as ata që do të përgjigjen. E theksoj dhe një herë: do të ndërpres në rastin më të parë, nëse do të shoh shfaqje si ato të seancave parlamentare apo, herë-herës edhe të komisioneve të tjera.

Është shumë e rëndësishme të njihemi me thelbin, me argumentin. Mund të kemi pikëpamje të kundërta, por në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë të jemi të papëlqyeshëm për njëri-tjetrin.

Atëherë, meqenëse rendin e përcaktuam, do të doja një prezantim të të ftuarve, por me shpejtësi. Po e fillojmë nga e djathta.

Robert Budina – Unë jam Robert Budina, regjisor dhe përfaqësues...

Eduard Shalsi – Përfaqësues i Sindikatës së artistëve të skenës e të ekranit.

Adriatik Lapaj – Adriatik Lapaj, avokat, aktivist i shoqërisë civile, mbështetës i aktorëve dhe i artistëve në këtë rast.

Neritan Liçaj – Neritan Liçaj, aktor i Teatrit Kombëtar.

Gjergj Bojaxhiu – Gjergj Bojaxhiu, përfaqësues i Forumit për trashëgiminë kulturore.

Adriana Tolka – Adriana Tolka, aktore në teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, përfaqësueses e Sindikatës së artistëve të skenës e të ekranit.

Agron Hysenlliu – Agron Hysenlliu, drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Ndërtimit.

Bruno Shllaku – Aktor dhe regjisor i teatrit “Migjeni”, Shkodër.

Eduard Shalsi – Në rregull! Faleminderit!

Nuk ka person tjetër në radhën e dytë? Atëherë, vetëm një pjesë e vogël është paraqitur?
Në rregull!

Meqenëse prezantimin e filluam nga Roberti, për lehtësi orientimi ta vijojmë nga ai. Robert, fjala për ju. Vetëm, të lutem, afroje pak mikrofonin, sepse nga larg është e vështirë të dëgjohesh.

Robert Budina – Faleminderit shumë, që na keni dhënë mundësinë të shprehemi. Në mëngjes ishim në Komisionin e Medies, ku folëm pak a shumë si artistë, ndërsa këtu kam përshtypjen se do të flas si qytetar i angazhuar dhe si intelektual.

Historia me Teatrin Kombëtar është shumëvjeçare. Ka njëzet vjet që ka filluar, dhe që atëherë kemi pasur konflikte të hapura me Kryeministrin, i cili që në atë kohë ka dashur që Teatri Kombëtar të shembej dhe të ndërtohej një godinë biznesi. Më vonë teatri ngeli në gjendjen që ishte, nuk u zhvillua më, nuk u hartuan ligje për teatrin e për artin në përgjithësi, kështu që teatri degradoi në vazhdimësi.

Sot na vjen një projekt nga qeveria, i cili, me aq sa kemi konstatuar me miqtë tanë juristë e avokatë, nuk është transparent dhe, për mendimin tim, si intelektual e si qytetar, teatri, dhimbja e artistëve, pamundësia e tyre, janë përdorur për të krijuar këtë lloj biznesi, që ju doni të bëni me këtë projekt.

Me sa i kemi ndjekur në vazhdimësi debatet tuaja, kemi parë se ky projekt vazhdon të jetë jotransparente, dhe ne nuk jemi të qartë për atë që do të ndodhë, por në thelb, ne jemi të vendosur se duhet të ruhet trashëgimia. Kohët e fundit shumë intelektualë të shquar kanë shkruar në lidhje me këtë çështje. Këtë që po bëni sot, ju duhet ta kishit bërë shumë kohë më parë. Përpara se ta bënit ligjin me kaq nxitim, duhej të na kishit pyetur, e jo vetëm ne, se ne s'jemi askush, por duhej të kishit pyetur përgjegjësit e kësaj pune, për të mos ardhur në këtë pikë, kur ju e bëni fakt të kryer, dhe kur kjo dëgjesë që po bëni me ne mund të trajtohet thjesht si procedurë, teksa në thelb e keni vendosur.

Unë dua t'ju bëj një thirrje, si qytetarë, si njerëz, që ta mendoni mirë këtë ligj, sepse kam përshtypjen se po projektohet një model shumë i rrezikshëm me një ligj-kontratë, i cili pastaj mund të vazhdojë nga të gjitha palët e politikës. Pushtetet mund të ndërrohen, por dëmi që i shkaktojmë Shqipërisë është shumë i madh.

Ky është mendim imi personal. Nuk duhet ta projektojmë këtë lloj modeli me një ligj, të cilin do ta shpjegojnë edhe më mirë se unë miqtë tanë, meqenëse unë s'jam i fushës. Kam një

ndjeshmëri intelektuale, nuk kam asnjë varësi politike. ne jemi miq, që kemi vuajtur shumë në art, me punën që kemi bërë. Si rezultat i mungesës së buxheteve, edhe sot na thuhet se, meqë nuk kemi lekë për kulturën, po përpiqemi me anë të një privati, ndërkohë që vendet e rajonit e kanë pesëfish me të lartë se sa ne. Kjo më duket miopi nga ana e qeverisjes, e cila s'është kujdesur për kulturën. Në qoftë se ju do të an e kishit dhënë këtë mundësi, unë ju premtoj që, me forcat e mëdha që kanë artistët në Shqipëri, do të kishim bërë çudira, dhe nuk do të ishim duke folur këtu.

Ju falënderoj shumë për mundësinë që më dhatë për t'u shprehur!

Uroj që ju të bëni më të mirën!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Budina!

Fjala për zotin Lapaj.

Adriatik Lapaj – Të nderuar anëtarë të këtij komisioni, deputetë të Republikës së Shqipërisë, përfaqësues të popullit shqiptar.

Nuk kemi ardhur me dëshirë sot këtu, por është detyra e qytetarit që na thërret të bëjmë një mbrojtje, për aq sa ne kemi takat e mundësi. Në raport me shtetin, sigurisht që shteti është më i fortë se ne, me mekanizmat që ka, por në raport me të drejtën dhe argumentet, besoj se në këtë rast jemi ne më të fortë, gjë të cilën do ta shpjegojmë si më poshtë.

Ne nenin 4, pika 2 të këtij draft-projektligji, thuhet: “Sipërfaqja që përbën pronën e Teatrit Kombëtar do të jetë po ajo, edhe pas përfundimit të Teatrit Kombëtar të ri.”.

Projektligji nuk përcakton qartë se çfarë nënkupton me sipërfaqe. A është sipërfaqe ndërtimore, dhe sipërfaqe totale e truallit ku ngrihet ndërtesa e Teatrit Kombëtar, e njëjta gjë? Pra, kur themi “sipërfaqe”, duhet të përcaktohet se cila sipërfaqe.

E dyta, ky projektligj nuk shprehet për Teatrin Kombëtar Eksperimental. Po sipërfaqja e tij, do të jetë e njëjtë? Nëse i qëndrojmë faktit se ju doni ta merrni këtë vendim dhe ta bëni. Sot kemi dy teatro në kompleksin në fjalë, por sipas ligjit në fjalë do të mbetet vetëm njëri. Atëherë, sa është raporti i sipërfaqes aktuale të pronës, ku ngrihen këto dy godina, me sipërfaqen që mbetet pas zbatimit të këtij drafti-ligji, nëse miratohet?

A do të keni parasysh se në projektin në fjalë, që na është paraqitur, godina e Teatrit Kombëtar ka vetëm dy piketa? Unë nuk dua të hiqem si arkitekt, por prona nën urën e Teatrit Kombëtar mbetet e gjitha pronë për akses publiku, që do të thotë kalimi për te kullat që do të ngrihen.

Në nenin 5, pika 2 thuhet: “Komuniteti i aktorëve teatrorë përfaqësohet në komisionin e negociimit me jo më shumë se dy përfaqësues, të zgjedhur nga vetë ata”.

Pyetje: kush e përcakton formulën se si zgjidhen nga vetë aktorët përfaqësuesit e tyre? Ne mund të dyshojmë se mund të jenë njerëz të pushtetit. “Nuk mund të marrin pjesë në komisionin e negociimit persona që kanë konflikt interesi” – thotë ky draft-projektligj – “me partnerin privat, sipas kuptimit të ligjit për konfliktin e interesit, e për këtë arsye anëtarët e komisionit nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesave”. Pa paragjykuar njeri, sipas nenit 9 të këtij draft-ligji, që thotë: “Nënshkrimi i kontratës nga kryetari i bashkisë Tiranë ose personi i autorizuar prej tij, bëhet brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes së projekt-kontratës dhe relacionit përmbyllës të negociatave”.

Pyetje: mos vallë kryetari i bashkisë është pak si në konflikt interesi, pasi ka qenë nën hetim nga vëllai i administratorit të kompanisë në fjalë?

Pyetje tjetër: a e di ky komision i nderuar se sa kontrata ka kjo kompani me bashkinë e Tiranës?

Përse me kaq nxitim ky projektligj? Kaq prioritet e urgjencë paska kjo çështje? Kjo çështje, sipas këtij komisioni të nderuar dhe përfaqësuesve tanë në parlament, paraqet më shumë urgjencë se sa çështjet që unë do të listoj më poshtë, e që ky parlament nuk ka marrë asnjë iniciativë për të ndryshuar situatën?

1-VKM-në për energjinë elektrike, për klientët në nevojë. Ligji nr. 43, këshilli i Ministrave...

Eduard Shalsi – Të lutem, vetëm një sekondë!

Po flasim për argumentet pro dhe kundër. Do t’ju lutesha të përqendrohemi, sepse për çështje të ndryshme...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ju lutem!

Adriatik Lapaj – Mënyra se si i shpjegoj, besoj...

Eduard Shalsi – Desha të sjell në kujtesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Lapaj – Besoj se jam brenda temës.

Eduard Shalsi – Thjesht desha të të rikujtoj, që të përqendrohesh te kjo çështje.

Adriatik Lapaj – Absolutisht!

Eduard Shalsi – Sa për të ta sjellë në vëmendje.

Adriatik Lapaj – Unë po flas shumë qetë. Për mua si qytetar, si avokat, dhe për ne si qytetarë të Republikës së Shqipërisë, çështja e prioriteteve duhet të ketë hierarki dhe radhë. Që të kalohet me procedurë të përshpejtuar një ligj i posaçëm, me porosi për një firmë private, ndërkohë që ne si qytetarë, çështjet e mëposhtme i kemi problematika, por që nuk zgjidhen...?! Unë do t'i citoj. Në daçi, merrini parasysh:

1-VKM-ja për energjinë elektrike, që Këshilli i Ministrave, në bazë të ligjit 43, të vitit 2015, që ky parlament e ka miratuar “Për sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 95, pika 1 thotë: “Klienti në nevojë”: “Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Energjinë, Ministrinë e Financave, në konsultim me ERE dhe grupet e interesit, harton kritere e procedura për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 108 i po këtij ligji thotë: “Këshilli i Ministrave ngarkohet që brenda dymbëdhjetë muajve të nxjerrë VKM-në”.

Kanë kaluar tridhjetë e gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe Këshilli i Ministrave është njëzet e katër muaj me vonesë për të nxjerrë VKM-në për përcaktimin e kritereve të klientëve në nevojë. A e dini se cilat janë pasojat e mungesës së kësaj VKM-je?

Eduard Shalsi – Të lutem shumë!

Është një numër i konsiderueshëm mbledhjesh komisioni, dëgjësash për energjinë, për mbetjet, për çdo lloj çështjeje. Jeni më shumë se i mirëpritur, qysh javën që vjen...

Adriatik Lapaj – Do të kisha mbaruar unë...

Eduard Shalsi – Ju bëra një sqarim që në fillim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi një sekondë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thashë dje, po e them edhe sot...

Adriatik Lapaj – Atë që do të them, e di unë, nuk e di ti.

Eduard Shalsi – Një sekondë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju thashë: do të ngresh dorën, do të ta jap fjalën. Përndryshe, po ju them: e ndërpres komisionin që tani. Nëse keni ardhur për të përsëritur skenat e komisioneve të tjera, ma thoni, e zgjidhim shumë kollaj, mbyllim mbledhjen dhe mirupafshim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Lapaj – Meqenëse kjo e energjisë dhemb...

Eduard Shalsi – Të lutem, të lutem!

Adriatik Lapaj – Janë 39 mijë kallëzime penale për këtë çështje, por le të vazhdojmë më tej. Po e kaloj, s'ka problem. Nuk dua debat.

Eduard Shalsi – A ka mundësi at fikësh mikrofonin një sekondë?

Adriatik Lapaj – Urdhëro?

Eduard Shalsi – Fike pak mikrofonin!

Për cilindo nga ju, që në aspektin procedural ka diçka për të sugjeruar, ja ku e keni përfaqësuesin! Ngrini dorën. Zonja Ulqinaku, do t'jua jap fjalën për aspektin procedural.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi ta marrësh fjalën tani, po të them prapë! Çfarë njerëzish jeni kështu? Do ngresh dorën, do të ta jap fjalën. E ka ngritur dorën zoti Spaho, do t'i jap fjalën. Kaq. Vetëm kaq dua.

Tani, të ftuarit po u sugjeroj një gjë: jeni më shumë se sa i mirëpritur për të ngritur çështje të tjera, enkas, në lidhje me sektorë të ndryshëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

More, qenke i çuditshëm!

Adriatik Lapaj – S'jam i çuditshëm! Jam qytetar i shkolluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Patjetër që do të ta jap fjalën. kam vetëm një kërkesë. Dua t'jua bëj të qartë se nuk ka shanse që në këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, zoti Mima, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Florjon Mima – A ka mundësi të mbarojë dhe të ecim përpara? Po filluam me sqarime...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – A mund të bëj një sugjerim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ka ngritur dorën zoti Spaho.

Edmond Spaho – Një sugjerim.

Zoti kryetar, mua më duket seanca...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Mos e ndiz, se ka një propozim nga nënkryetari! Fike pak atë, fike, pastaj ta jap unë fjalën.

Edmond Spaho - Me qetësi!

Eduard Shalsi - Nënkyetari ka një propozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi? Fike pak mikrofonin!

Edmond Spaho – Ai ma dha fjalën mua.

Eduard Shalsi – Ta dha fjalën ty, por pa më thënë mua.

Ju lutem shumë!

Po i bëj një sugjerim dhe po i them, për çështje që janë jashtë rendit të ditës, për energjinë që është një nevojë, jemi shumë të interesuar t'i theksojë dhe të vijë t'i shprehë. Sot të përqendrohet tek argumentet.

Urdhëroni, zoti Mima!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ngrini dorën dhe unë nuk pengoj njeri që të flasë.

Florjon Mima - Zoti Lapaj, këtu keni ardhur i ftuar si përfaqësues i një grupi që mbrojnë interesat e qytetarëve. Ndhuni i lirë si në shtëpinë tuaj dhe thoni çfarë t'ju dojë e bardha zemër, madje edhe me zë të lartë. Ne jemi të detyruar t'ju dëgjojmë.

Faleminderit!

Adriatik Lapaj - Zoti Mima andej nga jam unë është vështirë të bëj pas, por nejse.

Edmond Spaho - A mund të bëj një ndërhyrje?

Zoti kryetar, seanca nisi shumë mirë. Ne u kemi dhënë atyre 7 minuta në dispozicion. Ata kanë mënyrën e tyre sesi do të ekspozojnë pikëpamjen që mbrojnë. Brenda atyre 7 minutave, le t'i dëgjojmë. Nuk mund t'ju themi sot: duhet të kishe thënë këtë, apo atë. Qëndrimin e tyre e argumentojnë vetë. Këto 7 minuta të dëgjojmë secilin, pastaj të kalojmë në diskutime. Me ndërhyrjen tuaj më duket se po krijoni situata të pakëndshme dhe të panevojshme.

Eduard Shalsi - I bëra një sugjerim që brenda 7 -minutëshit të përqendrohen tek argumentet për teatrin. Nuk ka asgjë të keqe.

Adriatik Lapaj - E dëgjova sugjerimin dhe do të mundohem të jem shumë konciz. Ne si qytetarë të Republikës së Shqipërisë besojmë se më shumë emergjencë do të kishte ligji “Për statusin e minatorit”, ligji “Për referendumet”, që na interesojnë shumë, por çuditërisht këto nuk paskan emergjencë. Paska emergjencë një kontratë e posaçme për një firmë të caktuar me emër të përveçëm.

Vazhdojmë në aspektin juridik, për të cilin jam kryesisht këtu.

Të nderuar deputetë, ky ligj siç e dini është një ligj i thjeshtë, miratohet me shumicë të thjeshtë. Ndërsa ligji nr. 139 i vitit 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” referuar nenit 81, pika 2 të Kushtetutës votohet me shumicë të cilësuar. Pra, ka një ligj, ligji nr.139 “Për vetëqeverisjen vendore”, që përcakton në brendësinë e tij mënyrën sesi tjetërsohen pronat apo jepen me qira nga njësitë e qeverisjes vendore.

Nga ky komision dhe nga ky parlament duhet të bëhet një ligj i posaçëm për të dubluar një ligj, i cili është ligj organik. Juridikisht kemi përballë në këtë rast një ligj të posaçëm, që është draftligji që po diskutohet në këtë komision, me një ligj organik, që është ligji nr.139 “Për vetëqeverisjen vendore”. E thënë me shifra kemi përballë 36 vota me 84 vota. Ligji që doni të kaloni është një ligj që me 36 vota miratohet, ndërsa ligji “Për vetëqeverisjen vendore”, që përcakton dhe rregullon në parim për të gjithë republikën sesi tjetërsohen pronat në Republikën e Shqipërisë, kërkon 86 vota. Pra, legjislatori dhe ne si qytetarë kur kemi shprehur vullnetin tonë përmes Kushtetutës, kemi parashikuar që në lidhje me këto çështje kuorumi të jetë më i gjerë sesa 36 anëtarë të një partie politike. Për rastin në fjalë, Teatri Kombëtar.

Do të marr një sinonim me bunkerin në hyrje të Pogradecit. Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka harxhuar disa milionë euro për të ruajtur një bunker të Luftës së Dytë Botërore e po gërmon një mal të tërë në hyrje të Pogradecit. Por, nuk qenka në interes të saj të ruajë Teatrin Kombëtar të Republikës së Shqipërisë?!

Ne nuk jemi kundër ndërtimit të një teatri të ri. Beogradi ka 18 teatro. Bujrum! Bëjeni në “Bulevardin e ri”, por jo aty. Sepse aty është një tentativë për të grabitur pronën publike. Referuar kuadrit tonë ligjor i gjithë ku draftligji dhe e gjithë kjo iniciativë, në gjykimin tonë, është antikushtetuese, për sa kohë nuk i referohet nenit 83, pika 1. Nëse doni të bëni një ligj

organik për t'ia dhënë “Fusha sh.p.k” atë truallin atje, bëjeni, nëse i keni 84 vota, në të kundërt me 36 votat po shkelni ligjin me të dyja këmbët.

Sinqerisht, shumë modestisht, nga një qytetar i Republikës së Shqipërisë që mban një titull avokat.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Liçaj.

Neritan Liçaj – Jam biri i dy prindërve që më kanë edukuar me frymë patriotike. Jam krenar që i kam ata prindër dhe besoj se janë krenarë që unë jam këtu para jush. Në vitin 1988 unë fillova Institutin e Lartë të Arteve. Po në atë kohë shpallemi armiq të popullit, sepse ime motër kreu një akt të pastër disidence, duke u arratisur nga Shqipëria. Kam qenë student i “Dhjetorit” dhe i refleksioneve. Jam babai i dy djemve dhe një bashkëshorteje të mrekullueshme. Jam këtu para jush, duke ju parë në sy:

Faleminderit, që më dhatë mundësinë!

Në radhë të parë jemi njerëz, nuk kam asnjë hije dyshimi dhe asnjë pikëpyetje brenda vetes time, që jam në të drejtën time. Sinqerisht, me përulësi dëshiroj të kujtoni formulën tuaj të betimit: “Përpara flamurit, kombit dhe popullit”. Jeni deputetë të Kuvendit. Në atë Teatër Kombëtar unë kam parë për herë të parë të nderuarin Prokop Mima, Sandër Prosin, kam punuar me profesor Bertin, me profesor Çimin, me profesor Landin, me profesor Bujar Lakon, me Lizën, me Yllkën, me Violeta Manushin. Ajo skenë bie era art, të jeni të bindur, dhe asnjë lloj ere tjetër.

Zotërinj, ne artistët nuk jemi përçarë, nuk shitemi dhe nuk blihemi siç jemi përbaltur. Pyes veten, kujt i intereson kjo? Kemi mendime të ndryshme dhe kjo është normale në demokraci, por nuk shitemi. Kemi një flamur, flamurin shqiptar. Ne i jemi betuar pentagramit, skenës, ekranit, telajos, kuantëve. Ju i jeni betuar flamurit shqiptar. Përpiquni të kuptoni peshën e rëndësisë që ka vendimi që ju do të merrni. Është Teatri Kombëtar Shqiptar, nuk është Tirana, nuk është vetëm Shqipëria, është Prishtina, është Shkupi. Ju e dini fare mirë sesa sy janë drejtuar tek ai Teatër Kombëtar.

Me shumë përulësi ju kërkoj të shikoni të dashurit tuaj sot në darkë, bashkëshortet, bashkëshortët, fëmijët tuaj, prindërit, vëllezërit dhe e gjeni aty përgjigjen. Një ditë mund t’ju pyesin: kundër kujt votuat? Kundër Teatrit Kombëtar? Pse iu vërsulët artistëve? Është në dorën tuaj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Liçaj!

Zoti Bojaxhi.

Gjegj Bojaxhi- Faleminderit, zoti Shalsi!

Kompleksi teatror, sot Teatri Kombëtar dhe Eksperimental Kombëtar, mbart një histori të jashtëzakonshme 80-vjeçare për shoqërinë dhe për shtetin shqiptar. Një histori kulture, por edhe politike që, të paktën pjesërisht, regjimi i mëparshëm me dije dhe pa dije na e kishte fshehur. U desh një studiues i vetëm, falënderoj zotin Plasari për kontributin e tij, për t'i nxjerrë në pah akoma më shumë këto vlera të këtij objekti.

Historia dhe ngjarjet që kanë ndodhur në këtë godinë, përtej arkitekturës unike, janë arsyt kryesore për ta ruajtur objektin. Duke prishur godinën, ose më saktë këtë tempull të kulturës sonë, historia harrohet. Kombet ekzistojnë në sajë të kulturës dhe kujtesës. Duke e prishur, ne zyrtarizojmë fshehjen e historisë. Duke e prishur, ne dëmtojmë memorien tonë kulturore dhe shtetformuese në një kohë kur ne kemi nevojë më shumë se kurrë për të.

Më lejoni t'ju vë në dukje se shtëpia e Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, nga ana arkitekture, është një godinë e rëndomtë. Por ajo që e bën të veçantë dhe e kthen në një tempull për ne, nuk janë 4 muret katrore, pa asnjë vlerë në vetvete, por fryma dhe shpirti i atyre burrave që punuan dhe vepruan aty brenda. Ishte shpirti i atyre burrave që, në një moment kyç të këtij kombi, e kthyen në tempull.

Qëndrimin të Ministrisë së Kulturës, se ky objekt nuk është vlerësuar kurrë për t'u kategorizuar si moment i trashëgimisë, do t'i përgjigjesha duke i thënë: ky nuk është një argument, por një turp për këtë ministri.

Unë si qytetar i përgjegjshëm i këtij vendi ndihem i fyer që shteti më thotë se nuk ka para të restaurojë Teatrin Kombëtar, pa më bërë një herë të vetme thirrje për kontribut. Sa herë shteti shqiptar ka bërë thirrje, qytetarët i janë gjendur. Ky është një funksion bazë edukativ i shtetit që të edukojë shoqërinë aty ku e ndien me probleme. Le të na bëjë shteti dhe qeveria shqiptare thirrje dhe unë do të jem i pari në radhë që do të dhuroj për të restauruar Teatrin Kombëtar. Po e deklaroj këtë gjë publikisht këtu. Bëjeni këtë thirrje si shtet dhe do të shikoni reagimin e qytetarëve!

Kam edhe një pyetje, ju që jeni këtu si deputetë, a nuk do të jepnit rrogën e një muaji për të restauruar Teatrin Kombëtar?

Pyetjes që nuk i është përgjigjur kurrë askush: pse duhet të prishet ky Teatër Kombëtar për të bërë një tjetër? Mos vallë numri i qytetarëve që ndjekin teatrin ka rënë për shkak të vjetërsisë së godinës? Unë besoj se vjetërsia e godinës është vlerë dhe joantivlerë.

Kjo provohet edhe nga arsyeja që qytetarët e Tiranës, si edhe shumë midis jush, gjatë fundjavave shkojnë me vrap në Korçë, apo turistët e huaj që vizitojnë pa fund Gjirokastrën, Beratin dhe Krujën. Mos vallë nuk frekuentohet teatri për shkak të kalibrit të aktorëve të sotëm që Kryeministri me kaq shumë dëshirë përpiqet t'i përmendë dhe t'i denigrojë? Atëherë, pse po këta qytetarë ngulen me dhjetëra dhe mijëra përpara ekranit të televizorit për të parë po këta aktorë gjatë fundjavave?

Nëse ne flasim për korifentë e skenës kjo godinë është tempulli i tyre, që sot disa kërkojnë ta prishin. Korifentë nuk u bënë të tillë thjesht nga talenti i tyre, apo nga cilësia e sallës, apo edhe nga materiali i ndërtimit të godinës, por nga fryma dhe morali që përçuan duke farkëtuar breza të tërë me një identitet civil. Ne as nuk i nderojmë dhe as nuk mund ta ruajmë këtë frymë duke prishur tempullin e tyre.

Në historinë njerëzore, në asnjë vend më parë nuk ka pasur lindje të vlerave në shoqëri që e kanë ndërtuar dhe kanë pretenduar t'i ngrenë këto vlera me xhama, me asfalt, me beton, me hekura as me pazare politikanësh dhe me biznese të mbyllura. Ndërtimi i një teatri të ri kombëtar në këtë mënyrë, jo vetëm që po tenton të shkatërrojë në mënyrë të dhunshme historinë kulturore dhe politike të këtij vendi, por po na thellon antivlerat e arrogancës, manipulimit dhe patronazhit. Këto antivlera na kanë futur dhe vazhdojnë të na fusin edhe më thellë në krizën në të cilën po lëngon kaq gjatë shoqëria jonë.

Ky teatër i ri kombëtar, i prezantuar nëpërmjet këtij ligji është një dështim i frikshëm në nevojën që ka shoqëria jonë për të farkëtuar një frymë dhe një identitet bashkëkohor europian, në mënyrën se si ka ardhur deri këtu dhe për përmbajtjen që mban në vetvete. Ne, si Forumi i Trashëgimisë Kulturore, kërkojmë kthimin e këtij ligji.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Bojaxhi!

Fjalën e ka zonja Tolka.

Adriana Tolka - Faleminderit për mundësinë!

Mendoj se fati i Teatrit Kombëtar dhe i Teatrit Kombëtar Eksperimental shkon paralelisht me fatin e statusit të artistit të teatrit gjatë gjithë këtyre viteve të demokracisë në Shqipëri.

Statusi i aktorit të teatrit. E cilësoj këtë gjë, sepse jemi një kategori shumë e cilësuar si nga vlerat, ashtu edhe nga të ardhurat që sigurojnë ekzistencën e një artisti. Ky reflekton mungesën totale të lirisë së artistit sot, sepse nuk mund të flitet për liri dhe dinjitet të artistit kur rrezikohet ekzistenca e tij. Ka artistë sot që mbahen vetëm me atë rrogë, luftojnë për ekzistencën fizike të vetes dhe të familjeve të tyre. Po bëhen 20 vjet që jam në këtë profesion, kam luajtur në të dyja sallat, dhe në 4 vitet e fundit e kam përqendruar veprimtarinë time teatrore në të dyja sallat e Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”. Kam një pyetje: përse në këtë debat të madh nuk përmendet fare emri i këtij teatri? Janë dy institucione të ndara. Mundësisht do të doja një përgjigje.

Së dyti, doja të thosha se Teatri Kombëtar Eksperimental është gjymtyra simotër e Teatrit Kombëtar dhe është shembulli më i mirë se kur ka vullnet të mirë dhe dashuri, pavarësisht mundësive ekonomike, gjërat mund të ndryshojnë shumë për mirë. Falë vullnetit kryesisht të drejtorit Kiço Londo, të shumë miqve të tjerë, të vetë stafit krijues dhe mbështetës të këtij teatri, ai teatër mund të themi se në shumë gjëra është si nata me ditën me Teatrin Kombëtar Eksperimental. Jo në aspektin artistik, por në aspektin material dhe të kushteve të punës dhe të shfaqjeve. Me fare pak para dhe me shumë dashuri, nuk e kuptoj pse një gjë e tillë nuk mund të bëhet me Teatrin Kombëtar.

Ritheksoj, i mëshoj pyetjes së parë, pse Teatri Kombëtar Eksperimental nuk përmendet fare në këtë debat të gjerë? A thua se do të shkonte ndesh me qëllimet e atyre që duan ta prishin Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Kombëtar Eksperimental? Do të shkonte ndesh me interesat e Ministrisë së Kulturës, e cila ka qenë si njerëz gjatë këtyre 4 vjetëve ndaj institucionit tonë, duke zvogëluar vazhdimisht buxhetin e tij? Po ju them se njerëzit në atë institucion janë heronj. Ata ushqehen me byrek dhe janë heronj. Më dridhet zëri kur e them këtë, sepse jam dëshmitare ditaditës e kushteve në të cilat ata bëjnë art të madh.

Dua të them se në ato dy salla të Teatrit Kombëtar Eksperimental kanë kaluar breza. Nga më të rinjtë, deri tek yjet e skenës sonë. Të gjithë aktorët kanë kaluar aty. Shpeshherë kanë bërë kompromis me pagesa shumë të ulëta vetëm e vetëm nga dëshira për të bërë punë të mirë me vepra të mëdha. Në ato dy salla janë shfaqur vetëm vepra të mëdha.

Edhe një herë: ku do të shkojë Teatri Kombëtar Eksperimental?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Tolka!

Zoti Hysenlliu.

Agron Hysenlliu – Faleminderit, që po më dëgjon ky panel i nderuar!

Unë përfaqësoj Institutin e Ndërtimit, mbi bazën e të cilit kemi kryer një ekspertizë teknike në institucionin e Teatrit Kombëtar me një indicie që ka dhënë vetë ky institucion për të kryer...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër! Nuk doja të bërtisja shumë, se ne inxhinierët bërtasim shumë.

Ekspertizën e kemi bazuar në 4 shtylla. Shtylla kryesore ka qenë infrastruktura dhe arkitektura e vetë teatrit të vjetër, çështja e konstruksionit, pjesa...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Për procedurë?

Lorenc Luka - Po, nëse këtu kemi ftuar autoritete të ndryshme të shoqërisë civile, zotëria përfaqëson një institucion shtetëror dhe nuk mund të jetë prezent këtu bashkë me zotërinjtë e tjerë, sepse ka konflikt interesi. Ai është përfaqësues i institucioneve shtetërore dhe nuk mund të jetë këtu prezent në emër të shoqërisë civile.

Eduard Shalsi - Propozimi është shumë i qartë. Ndërkohë ai është thirrur, sepse ka një ekspertizë në lidhje me situatën aktuale dhe dëgjesat nuk përjashtojnë as institucionet e varësisë, as institucionet shtetërore dhe as grupet e interesit. Është pjesë e ndërgjegjësimit tonë për vendimmarrjen.

Zoti Hysenlliu, mund të vazhdoni!

Agron Hysenlliu - Faleminderit!

Zotërinj deputetë, në radhë të parë desha t'ju them se pavarësisht se punojmë në institucione shtetërore, unë jam inxhinier dhe nuk mund të bëj atë që nuk bëhet dhe të mos bëj atë që bëhet. Të më kuptoni drejt. Po vazhdoj me referimin që kam.

Problematikën që ka pasur Teatri Kombëtar e kemi ndërtuar në 4 shtylla. Pjesa arkitektonike, që ka të bëjë me infrastrukturën dhe lëvizjen e vetë ambientit dhe kryerjen e këtij aktiviteti nga personeli i Teatrit Kombëtar dhe nga vetë spektatorët që hyjnë në këtë teatër.

Ekspertiza e dytë ka qenë pjesa e konstruksionit, që ka rezultuar dhe e kemi parë se sa është në gjendje për të qëndruar pas 70 vjetësh dhe për të kryer një aktivitet të tillë në këtë teatër.

Ekspertiza e tretë ka qenë për sa u përket ngrohjes dhe ventilimit dhe sa është në gjendje kjo ekspertizë për t'u dhënë.

Ekspertiza e katërt ka qenë pjesa e elektrikut dhe mbrojtja kundër zjarrit. Në të 4 shtyllat që kemi bërë këtë ekspertizë, rezulton se Teatri Kombëtar nuk përmbush kriteret dhe nuk duhet të qëndrojë.

Zotërinj deputetë, po ju bëj një apel, si qytetar, si inxhinier, ju lutem, me përlësinë më të madhe, mos i lini ata njerëz të vazhdojnë aktivitetin në atë godinë!

Nëse gjithkush ka pikëpyetje le të shkojë aty. Të ngrenë një grup tjetër, jo ne, se mund të kenë pikëpyetje për ne, ne kemi qenë inxhinierë nga të gjitha fushat, dhe të shkojnë aty dhe ata inxhinierë të dalin përballë nesh dhe të na japin opsionet e tyre për Teatrin Kombëtar.

Për sa i përket arkitekturës, ajo nuk plotëson asnjë lloj infrastrukture. Mbi bazën e numrit të qytetarëve që shkojnë atje, skena nuk është optimale. Aty nuk ka dhoma shërbimi për vetë aktorët. Aktorët janë të ndërgjegjshëm, sepse ne bëjmë takim me ta. Ne kemi bërë takim edhe me arkitektët dhe të gjithë arkitektët që ishin atje në dëgjese me mua më kanë dhënë plotësisht të drejtë. Në teatër nuk ka garderobë dhe të gjitha materialet që disponon Teatri ndodhen nëpër korridore. Janë zënë lozhet për t'u bërë dhoma për producentin apo për aktorët, janë vetëm dy banja në shërbim, të cilat janë të vjetra, të stilit allaturka, brenda të cilave ndodhet edhe lavanderia. Nuk ka atelie për kryerjen e punimeve të drurit dhe të çelikut që janë brenda ateliesë.

Problematika që është aty dhe që është më evidente është se objekti i vjetër është një ngrehinë e lehtë dhe ky objekt në kohë është çarë, ka bërë cedimet dhe ulje diferenciale të saj duke prishur panelet e objektit të vjetër. Si rezultat objekti, ngaqë nuk llogaritet për tërmete, i ka shpëtuar kohës. Rrezikshmëria e llogaritur, sipas probabilitetit që kemi kryer ne brenda Teatrit Kombëtar është 99%. 0.1% e ka ruajtur Teatrin Kombëtar deri tani.

Për sa i përket zjarrit, aty nuk ka asnjë sistem sinjalizimi. Nuk ka asnjë hidrant për të shuar zjarrin, vetëm dy fikse dore. Mungojnë pompat që ne i quajmë “pompat e zjarrit”, nuk ka depozita rezervë për ujin, mungon perdja e zjarrit që duhet të mbyllë...

(Diskutime pa mikrofon)

... atëherë unë po vazhdoj me rikonstrukcion, sepse këtu hyjnë të gjitha problematikat.

Në qoftë se ne do të rikonstruojmë një teatër të tillë, ai nga ana strukturore nuk plotëson kushtet, prandaj duhet të rrëzohet i gjithi.

Nga ana arkitektonike nuk plotëson kushtet, nuk ka volumet e duhura për të kryer një aktivitet të tillë kombëtar, prandaj rikonstrukcioni në të tilla gjëra nuk bëhet.

Po ju bëj një apel qytetar, në apel si inxhinier (ne e kemi dhënë edhe me shkrim): Teatri Kombëtar nuk duhet të funksionojë.

(Diskutime pa mikrofon)

Problematika e Teatrit Kombëtar për mua është që ai duhet të pezullohet. Kaq kisha. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Hysenlliu!

Urdhëroni!

Kreshnik Merxhani – Jam arkitekt i fokusuar në fushën e restaurimeve.

Shumë faleminderit që na jepni mundësinë të shprehemi!

Unë doja ta nisja me mundësinë e restaurimit ose jo të objekti në të cilin ndodhet Teatri Kombëtar.

Ka një gamë të gjerë argumentesh historike-urbane, sepse është brenda qendrës historike të Tiranës në të cilën me ligj nuk lejohen ndërtimet e reja. Ka edhe disa argumente estetike, sepse kemi të bëjmë me një projekt, një ansambël, që në gjenezë ka shërbyer si një objekt social-kulturor me teatër brenda, me kinema, me pishina, por edhe vendin ku kanë lindur të gjitha institucionet kryesore në këtë vend, jo vetëm ato kulturore, por edhe shkencore.

Jo më larg se dje lexuam që edhe Akademia e Shkencave e ka pasur fillimisht selinë e vet aty.

Le të kthemi tani tek argumenti se a mund të restaurohet apo jo, sepse do të ishte mirë të flisnim si qytetarë të përgjegjshëm. Nëse nuk i marrim parasysh kriteret e mbrojtjes nga zjarri, do të kemi shumë probleme në Gjirokastrë, në Berat, do të kemi shumë probleme edhe në Tiranë, madje edhe te ky objekt që po flasim. Nëse ne e pranojmë analizën që kanë bërë inxhinierët, duhet të themi se kemi bërë edhe ne të njëjtën gjë për Pazarin e Gjirokastrës, që është mbi 10 mijë metra katrorë, e kemi bërë edhe banesat e Babametove në Gjirokastrë ose edhe për një tjetër projekt shumë të suksesshëm të qeverisë, objekti i muzeut “Marubi”. Objekti i muzeut “Marubi” ishte praktikisht jashtë çdo lloj parametri, i braktisur, i rrënuar, i kthyer në një depo...

(Diskutime pa mikrofon)

Muzeu “Marubi” është një histori e jashtëzakonshme suksesi, që na bën krenar të gjithë. Pati një konkurs ndërkombëtar, pra nuk pati një proces të mbyllur. Ky objekt është mbi 300 metra katrorë dhe ka kushtuar vetëm 1,5 milionë euro dhe ka parametra bashkëkohorë të jashtëzakonshëm. Është nominuar për një çmim, që është një ndër çmimet më prestigjioze në

botë dhe të gjithë jemi krenarë. Ky objekt ka laboratorët e vet, ka të gjitha pajisjet e veta, si dhe ka pasur një mbështetje nga i gjithë komuniteti. Të dy grupimet e arkitektëve, edhe Unioni i Arkitektëve, edhe Shoqata e Arkitektëve kanë dalë në mbrojtje të ruajtjes dhe të restaurimit të Teatrit Kombëtar. Ne jemi për një teatër, pse jo edhe për 10 teatro dhe i kemi krahët e hapur për të gjitha këto, por pse aty, pse te ajo pjesë, e cila do të kontaminojë të gjithë qendrën historike?

Muzeu “Marubi” me të gjithë parametrat ka kushtuar rreth 758 euro metri katror, ndaj Teatri Kombëtar me këto parametra që ka, sikur edhe dyfish të kushtojë, prapë nuk i kalon 5 milionë eurot, që është një shifër shumë e konsiderueshme. Muzeu “Marubi” mbledhi Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Fondin Shqiptaro-Amerikan, një projekt europian, fonde zvicerane, si dhe ndihmën dhe përkrahjen që iu dha direkt drejtorit të muzeut, jo për të dalë dhe për të thënë që muzeu duhet prishur ose nuk duhet bërë, por u mbështet për ta bërë dhe ja ku kemi një histori suksesi.

Të njëjtën gjë kemi edhe në Gjirokastrë me objektet “Babameto”, kemi të njëjtën gjë me Muzeun e Artit Mesjetar, kemi të njëjtat gjëra me komplekset e pazareve, pra mundësia për t’i restauruar është krejtësisht e plotë.

Unë nuk po ndalem shumë te argumentet. Profesor Maks Velo i ndau në 4 grupe. Mu në mes të teatrit e rrëzoi edhe argumentin e mosdaljeve apo problemit të zjarrit, sepse tha është i vetmi institucion me pishinë, është i vetmi institucion që vetëm nga njëri krah ka pesë dalje, kështu që në një farë mënyre, në qoftë se ekziston mundësia, ne ju kërkojnë juve ta shihni në këtë fokus, edhe si një hap ekonomik, sepse është pronë publike, edhe si një qëndresë për memorien e kryeqytetit të shqiptarëve, jo të Shqipërisë, por të shqiptarëve.

Në qoftë se ne e trajtojmë trashëgiminë kulturore në këtë formë, shihni se si do ta trajtojnë vëllezërit tanë që ndodhen në kushte shumë më të vështira, në Preshevë, në Maqedoni, në Malin e Zi apo në Kosovë. Le t’u japim atyre shembullin që ne dimë të restaurojmë, dimë të ruajmë, dimë të vlerësojmë mu në qendër të qytetit tonë dhe të kryeqytetit të tyre.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Taçi!

Ervin Taçi – Nuk jam ekspert i restaurimit, por jam arkitekt. Nga pikëpamja teknike e restaurimit nuk e diskutoj se mund të jenë të gjitha mundësitë për të realizuar një restaurim, por

gjithsesi teatri do të na ngelej në një dimension minor, jo me ato pritshmëri që kemi për të pasur një Teatër Kombëtar.

Nisur edhe nga eksperiencia që kemi pasur në projektimin e teatrit të Korçës dhe të Maliqit, kemi pasur situata të ngjashme të ndërhyrjes në një objekt ekzistues, të rinovimit të një objekti ekzistues dhe kemi hasur vështirësi pa fund të bënim balancën ekonomike se çfarë do të sillte rinovimi dhe çfarë do të sillte një projekt i ri i realizuar nga e para do të rezultonte pa dyshim se ngritja nga e para do të ishte më efiçiente.

Në këtë rast jemi në një situatë kur do të pranojmë kosto të lartë për restaurimin, po çfarë kemi arritur në fund fare si konkluzion? A kemi arritur të ndërtojmë një teatër kombëtar me ato dimensione që pretendojmë? Kjo është çështja. Pra, nuk diskutoj fare që në nivelin e sensibilitetit të trashëgimisë apo të sensibilitetin e vetë aktorëve, nuk mund ta diskutoj dot këtë temë, se nuk më përket mua. Nga pikëpamja teknike, nëse pretendojmë të ngremë një teatër të mirëfilltë, që të na përfaqësojë të gjithë shqiptarëve, Prishtinë, Maqedoni dhe më gjerë, jemi në kushtet e një objekti, i cili e ka gati të pamundur arritjen e këtyre objektivave.

Eduard Shalsi - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Shllaku!

Bruno Shllaku – Kam një dëshirë të vetme, që t’u tregoj disa njerëzve, të cilët thonë “Unë jam teatri”, ku është teatri i vërtetë.

Me gjithë respektin që kam për këta njerëz këtu, se i kam shokë, miq, dashamirë, kur ne themi që ai teatër duhet të ribëhet, ne s’i përkithemi teatrit! Djali i Lec Shllakut, Artist i Popullit, shkrimtarit, poetit, interpretues i sa e sa roleve si në teatër, si në kinematografi, themeluesi i teatrit “Migjeni” që nga themelet, themeluesi i teatrit “Skampa”, themeluesi i estradës dhe teatrit “Ushtari”, kujt i përkas unë? Cilit teatër i përkas unë?

Unë di se vetëm teatrit të Shkodrës nuk i përkas, sepse bënë gjenocid ndaj njerëzve që bënë punën. Nuk e di ç’është kjo tollovi që njerëzit, fatkeqësi e madhe, duan me çdo kusht të krijojnë lindje të vështira, me operacione cezariene! Pse? Nuk e kuptoj. Kam ngelur sot mbi një orë për të hyrë në dyert e Tiranës. M’u kujtua viti 2007, nata e Vitit të Ri në Nju Jork, kur prita 4 orë për të hyrë. M’u bë qejfi se thashë edhe në Nju Jork qenka kështu, por jo këtu. E pse ndodhi gjithë ajo tollovi? Për një mbikalim që u rrënua dhe ne nuk na shoqëroi policia për të na hapur rrugën, ne që duartrokitemi, djersijmë.

Unë e kam shumë të vështirë të them... Kjo fjala “shembje” për mua është fatalitet. Unë nuk jam për fjalën “shembje”, por jam për atë që thotë Shekspiri “Teatrin e bëjnë njerëzit. Më jepni një çarçaf dhe unë do të loz kryeveprën time “Mbreti Lir”!”

Ai teatër është jashtë çdo parametri. Unë jam i detyruar të bëj edhe një lapsus në kujtesë, se e kam pasur mik shumë të mirë, por meqë ishte pedagog imi, anipse kurrë nuk e kreva shkollën e aktorëve, i nderuari, i madhi Kadri Roshi, më thoshte: “Bruno, më vjen turp të dal në atë skenë. Është për ibret të Zotit. Pse nuk vë qeveria as edhe një dorë?”

Sot nuk dua të përkëdhelem me askënd. Unë jam ky që jam. Unë jam artist edhe i shoh gjerat emocionalisht. Të më falin njerëzit, sepse unë nuk i përkas matematikës, nuk u përkas shifrave, por u përkas emocioneve. Në atë godinë kanë kaluar kolosët e skenës, por të mos harrojmë se edhe në stadiumin Wembly kanë kaluar asët e botës në futboll. 1 miliardë e 800 mijë spektatorë kanë kaluar aty, por e shembën që ta ribënin të ri, edhe është një stadium i duartrokitshëm.

(Diskutime pa mikrofon)

... flisni, flisni, por unë nuk i përkas biznesit. Unë i përkas artit...

(Diskutime pa mikrofon)

Më lejoni t’i referohem retrospektivës, se unë kam kujtimet e babait tim, dhe kush nuk i ka lexuar, le t’i lexojnë! E njëjta zhurmë është bërë kur trupa e teatrit “Migjeni” me në krye Zef Jubanin, Lec Bushatin, Tinka Kurtin, Vitore Ninon e të tjerë, e të tjerë, ka dashur të abandonojë Teatrin e Jezuitëve, një teatër ku ka cituar poeti ynë kombëtar, padër Gjergj Fishta. Fatkeqësisht, ky teatër u shemb, u shemb për motive të tjera, por e njëjta zhurmë është bërë. Sot teatri “Migjeni” është një teatër i parametrave fantastikë, që na nderon gjithandej.

(Diskutime pa mikrofon)

Më lejoni, se brezit tonë i kanë vdekur baballarët 90-vjeç duke u marrë me art. S’e kam pasur babanë kurrë murator.

Teatri “Migjeni” është projektuar si teatër që nga themelet, kurse Teatri Kombëtar nuk ka qenë i projektuar si teatër. Teatri Kombëtar ka qenë një fjetore truprojash ...

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Shumë faleminderit!

Ke diçka tjetër për të shtuar, sepse kam përshtypjen se do ta mbyllësh?

Bruno Shllaku - Jam totalisht dakord. Por dua të përfitoj nga rasti, sepse këtu kemi edhe deputetë të nderuar të Komisionit të Ligjeve, ju lutem shumë që puna e artistëve të jetë më shumë në vëmendjen tuaj! Ashtu siç e tha edhe Liço, artistët janë në një gjendje të mjerueshme dhe në një çast para fatales. Jam totalisht dakord për teatrin e ri, siç jam totalisht edhe për njerëz të rinj në çdo teatër shqiptar.

Faleminderit, i dashur!

Eduard Shalsi -Shumë faleminderit!

Zonja Ulqinaku, ju garantoj se e kam shënuar emrin tuaj të parin.

Kush ka pyetje?

Fillon zonja Ulqinaku, pastaj zoti Spaho, pastaj zoti Bumçi.

Izmira Ulqinaku - Pyetja ime është për zotërinjtë. Nuk e kuptova kush ishte këtu, përfaqësuesi i qeverisë, apo i inxhinierëve, sepse, në qoftë se është i inxhinierëve, të gjithë ato arkitektë dhe inxhinierë që na dëgjojnë, është turp i botës për ato fjalë që tha...

Eduard Shalsi - E keni fjalën për zotin Hysenlliu ?

Izmira Ulqinaku – Po. Nëse është këtu si përfaqësuesi i qeverisë, ishte brenda rolit dhe e kuptoj.

Pyetjen e bëra edhe dje, por u mbyll mbledhja dhe nuk u përgjigjët. Pse sallat e Kryeministrit të ndërtuara me fibra karboni, godinë e ndërtuar në të njëjtën periudhë me Teatrin Kombëtar, u restauruan, si dhe e njëjta godinë, që është e ndërtuar me të njëjtat materiale, Ministria e Zhvillimit Urban, u restaurua, ndërsa Teatri Kombëtar nuk restaurohet?

Pse këto godina të ndërtuara me të njëjtat materiale, në të njëjtën periudhë, nga të njëjtët punëtorë, me projekt italian dhe me radhë, u restauruan, ndërsa Teatri Kombëtar nuk restaurohet dot? Kjo është pyetja ime. Para se të përgjigjesh, dua të di, sepse nuk e dëgjova, a jeni këtu si përfaqësues i inxhinierëve, apo i qeverisë?

Eduard Shalsi - Qartë!

Do t'i mbani shënim pyetjet, pastaj do t'jua jap fjalën unë.

Zoti Spaho!

Edmond Spaho - Faleminderit!

Edhe unë kisha një pyetje të ngjashme për drejtorin e institutit lidhur me atë që tha se duhet shembur një orë e më parë, madje bëri thirrje patetike, që të mos lejojmë njerëzit që të futen në teatër, sepse paska risk të madh. Pse nuk rikonstruktohet ky objekt?

Teatri i Elbasanit është edhe njëzet vjet më i vjetër, është 100-vjeçar, madje u dogj, u shkatërrua dhe prapë u rikonstruktua dhe u kthye në gjendjen fillestare, me pak para.

Pse në këtë rast bëhet dhe në atë rast nuk bëhet? Si do t'ia bëjmë ne me Teatrin e Kukullave, që është vendi ku është mbledhur parlamenti i parë, do ta prishim dhe t'i vëmë një kullë? Meqë qenka kështu, çfarë t'i bëjmë Beratit, ta prishim? Sepse kur është ndërtuar Berati, nuk është ndërtuar me kërkesat inxhinierike për energjinë elektrike, për ujin, për ujërat e zeza, e ku ta di unë. Po kështu ndodh edhe me Gjirokastrën. Pse i rikonstruktojmë kishat në Voskopojë, nuk i prishim dhe të ndërtojmë kisha të reja? Ta prishim kishën dhe të bëjmë një kishë të re ortodokse!

Pse nuk u prish para njëzet vjetësh ky teatër? Sepse të njëjtat argumente janë sjellë para njëzet vjetësh kur filloi historia e prishjes së Teatrit Kombëtar nga Edi Rama. Janë përdorur të njëjtat argumente: që nuk mban, është i mbaruar, nuk kemi zjarrfikëse, nuk ka ujë, do ta rrëzojë tërmeti e të tjerë. Tërmete kanë rënë pa fund, por unë nuk e di se godinat me konstruksione të lehta të shkatërrohen nga tërmeti. Edhe dje ra tërmet dhe nuk ndodhi gjë.

Prandaj ajo 99.99 %, që paska risk për t'u rrëzuar nga tërmeti, më duket se është thellësisht e ekzagjeruar dhe nuk mund të shërbejë si argument për ta rrënuar Teatrin. Për shembull, ju thatë se atje nuk ka ambiente ndihmëse për aktorët dhe se salla është e vogël. Sallë të vogël ka dhe tetari i komedisë në Paris, por ata e ruajnë, sepse ka historinë nga mbrapa. Edhe historia jonë, në kuptimin e artit dhe të kulturës së mirëfilltë, tetëdhjetë vjet ka që ka filluar, mos duhet ta prishim meqenëse nuk e kemi treqind vjeçare si në Francë?!

Në të gjithë atë sipërfaqe që ka teatri, nuk ndërtohen dot ambiente ndihmëse? Janë 8000 metra katrorë ta pashfrytëzuara, madje edhe ndërtuesi, kur e ngriti para tetëdhjetë vjetësh, u sigurua që t'i lerë tokë të mjaftueshme që të vazhdojë zgjerimin në përputhje besnikërisht me arkitekturën që ai ka, një katëshe, në mënyrë që të ruhet edhe historia, por edhe t'u përshtatet kërkesave të kohës.

Si u veprua me Bankën e Shqipërisë, që e zgjeruan dhe ia përshtatën?! Është i njëjti ansambël, është godinë e ansamblit të Bulevardit të Tiranës, e ndërtuar në të njëjtën kohë dhe është bërë shumë bukur. Banka e Shqipërisë edhe u zgjerua, edhe u ruajt historia e Tiranës. Këto ka Tirana! Tirana është qytet i ri, i ndërtuar, i shpallur kryeqytet para më pak se njëqind vjetësh. Pse duhet t'ia prishim të gjitha elementet e identitetit?! E prishën bashkinë, e prishën stadiumin,

tani duan të prishin edhe Teatrin? A është normale që dy objekte të qendrës, të të njëjtit ansambël duam t'i prishim për tri vjet?

Zotërinë që tha se nuk ka lekë buxheti i shtetit e pyes: pse nuk ka lekë buxheti i shtetit, për të bërë një teatër me 20 apo 30 milionë? Ende nuk e dimë koston, sa shkon kostoja e rikonstruksionit? Nuk është bërë ndonjë studim. Unë e kam fyerje ta dëgjoj nga teknikët e fushës, që të thonë “nuk bëhet” rikonstruksioni. Sot, jo me këto teknologji, por me teknologjitë e vjetra fare, rikonstruksioni bëhet dhe i plotëson të gjitha parametrat që janë të nevojshëm sot. Janë rikonstruktuar objekte mijëra vjeçare dhe janë kthyer në gjendje të përdorueshme nga njerëzit dhe nga vizitorët. Unë nuk po them: hajde ta zgjerojmë skenën, skena le të ngelet ajo që është, as kapacitetin, ai që është me 300-400 veta, por të ruajmë historinë e kulturës dhe të artit në Shqipëri dhe në Tiranë.

Doni të ndërtoni teatër me kapacitet të madh? Ka sa të duash vende Tirana, madje edhe në qendër ka, shkoni dhe ndërtojeni, por këtë mos e prekni, sepse është histori. Pse nuk e prishim ne godinën, që është në krah të Tetarit Kombëtar? A mund të ma thoni? Është e të njëjtës periudhë. Pse u rikonstruktua dhe ka dalë aq bukur, është për t'iu thënë bravo për punën që keni bërë. Prandaj duhet të ruhet edhe Teatri atje, sepse shkon me atë godinë, shkon me godinën përballë, shkon me të gjitha godinat e tjera, sepse qëkur është ndërtuar, është ndërtuar me këtë frymë. Ju e dini shumë mirë, shkoni dhe shikojeni në arkiva, është rrethi italo-shqiptar Skënderbeg. Prandaj mos thoni nuk hyn te pjesa e trashëgimisë, është te pjesa e trashëgimisë dhe është pjesë e pandalshme e të gjithë Ansamblit të Tiranës, që fillonte nga ish-bashkia dhe përfundonte tek Universiteti i Tiranës. Para ka pa fund.

“Rilindja urbane” që rregulloi të gjithë qendrat e qyteteve dhe ajo e “100 fshatrave”, që do të rregullohen, po të sakrifikojmë ndonjë fshat, e lëmë për disa vite më vonë, sakrifikojmë një rrugë, e lëmë për disa vite më vonë, dhe rikonstruktojmë Teatrin. Para ka pa fund. 1 miliardë euro ka vetëm projekti i tanishëm dhe nuk gjejmë dot ne 20 milionë euro. Nuk dua të bëj politikë tani dhe të hidhem te bagazhet e *Toyota*-s, sepse nuk është e hijshme, por është e turpshme për ne si shtet, të themi nuk gjejmë dot 40 milionë euro për të rikonstruktuar Teatrin. Ky nuk është argument për të na çuar në miratimin e atij vendimi.

Duke jua thënë drejt juve, zoti drejtor, nuk është problemi tek teatri, është problemi te toka e teatrit, sepse ju, që e keni parë projektin që do të ndërtohet atje, e dini shumë mirë se 3 kulla do të jenë tek toka e tetarit, do të jetë te 8 mijë metërshi. Në qoftë se rikonstruktohet Teatri,

nuk ka projekt. Madje edhe ajo pjesa në tokë private atij nuk i del e leverdishme, prandaj do që të marrë gjithë tokën, ta bashkojë me 1 mijë e ca metra, që ka atje, t'i bashkojë me 8 mijë metrat e teatrit dhe të ndërtojë 6 kulla. Këtu është e gjithë loja, sepse Teatri maksimumi do të marrë 3 mijë metra, po këto 5 mijë metrat e tjerë, pse duhet t'i bëjmë kulla?! Për këto më jepni përgjigje.

Eduard Shalsi - Absolutisht, nuk kam asnjë problem edhe do të kalojmë te diskutimet. Dua të përqendrohemi te pyetjet me të ftuarit dhe më pas mund të bëjmë diskutime dhe konkluzione.

Urdhëroni, zoti Beqaj për procedurë!

Ilir Beqaj – Zoti kryetar, unë nuk dua të polimizoj me zotin Spaho, por në parashtresën e tij, në gjysmën e kohës, u dha vetë përgjigje pyetjeve të tija apo bëri konsiderata, që janë shumë të vlefshme për debatin, por jemi në momentin që të bëjmë pyetjet, të marrim përgjigje, dhe më pas vazhdojmë debatin pa kufizim. Kështu që, i ftoj të gjithë kolegët të bëjnë pyetje dhe më pas kemi kohë me njëri-tjetrin për diskutime.

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Bumçi!

Aldo Bumçi – Dua t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe për prezantimin serioz dhe të përgjegjshëm. Kjo tregon se e ndjeni arsyen që keni ardhur dhe ishit përgatitur për të mbrojtur kauzën tuaj!

Kam tri pyetje.

Së pari, çfarë mendoni ju për emergjencën, si justifikohet emergjenca e kësaj nisme? Ju, si artistë, si e kuptoni emergjencën e qeverisë për të shembur Tetarin dhe për të ndërtuar një të ri? A keni emergjence atje? Në aspektin ligjor, ne për dy ditë, po kalojmë një projektligj dhe të enjten duhet ta kalojmë në Kuvend. Për tri ditë Kuvendi i Shqipërisë përgatit bazën ligjore për të shkatërruar Teatrin dhe për të zhvatur pronën publike. Si e justifikoni ju këtë emergjencë?

Pyetja e dytë ka të bëjë me gjetjet e Institutit të Ndërtimit. Dua mendimin tuaj, edhe të Forumit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, arkitektëve, pra si i vlerësoni gjetjet e institutit të ndërtimit? Nëse jeni në dijeni, a ka një ekspertizë të tyre?

Së treti, në fjalën tuaj ju përmendet sa ka kushtuar rehabilitimi i fototekës “Marubi”. Me shifra të përgjithshme, a mund të na thoni cili do të ishte ai investim, që do e sillte Teatrin në kushte më optimale pune? Për shembull, 19 milionë euro të investuara në sheshin “Skënderbej”, a do të mjaftonin për rikonstruksionin e teatrit, apo për pedonale në qytete, që më vjen keq ta them, por kanë vdekur, janë larguar qytetarët, pra investime dhe pedonale në qytete ku nuk kanë

mbetur më banorë prej kësaj qeverie? Cili do të ishte ai investim që do ta kthente këtë Teatër në një godinë të pranueshme për funksionin e saj?

Së fundi, kam një pyetje për të gjithë ne: pse ka nevojë për parlament dhe për ne këtu? Kryeministri bashkëqeveris me qytetarët, le të dalë në mëngjes te dritarja të deklarojë çfarë ka ndër mend të bëjë çdo mëngjes, nuk ka nevojë për ligje se ky nuk është ligj, ky është një turp i madh. Ky vetëm ligj që nuk është. Le të dalë në mëngjes dhe të thotë: sot në mëngjes kam vendosur të bëjë këtë gjë, nuk ka nevojë t'i referohemi as Kushtetutës, as ligjeve, sepse Shqipëria nuk ka më bazë ligjore. Le të deklarojë çdo mëngjes, sipas ëndrrave dhe fiksimit të tij, dhe ajo të jetë ligji dhe Kushtetuta e vendit.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Edhe një herë, dua t'ju rikujtoj të nderuar deputetë, se te pjesa e komenteve, secili është në të drejtën e tij të nxjerrë konkluzione, jemi te pjesa e pyetjeve.

Fjalën e ka zoti Shehaj për pyetje. Do ju lutesha të ishim sa më rigorozë te pjesa e pyetjeve.

Agron Shehaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja e parë: maxhoranca ka reklamuar arritjen e një marrëveshjeje midis kryebashkiakut dhe përfaqësuesve të artistëve. Dua të di, në qoftë se ju jeni në dijeni për një marrëveshje të tillë, cili prej jush ka qenë pjesë e kësaj marrëveshjeje, cilat janë kushtet dhe termat kësaj marrëveshjeje? Në qoftë se i dini.

Pyetja e dytë: gjithmonë nëpër medie kemi dëgjuar se Teatrin kanë cilësuar me terma të llojit “qebaptore, verriste, stallë kuajsh”. Tani, ju që e keni jetuar në atë teatër, a janë këto terma të saktë për të përcaktuar dhe për të cilësuar atë teatër? Realisht, ju që keni jetuar dhe keni punuar në atë Teatër.

Pyetja tjetër është kryesisht për arkitektët: për sa i takon restaurimit. Kur flitet për restaurim, unë besoj se nuk ekziston objekt që nuk restaurohet. Të thuash që një objekt nuk restaurohet, mua më duket pak absurde, nuk jam i kësaj fushe, por më duket vërtet absurde, sepse varet nga qëllimi i restaurimit. Një mur kalaje i rrënuar, restaurohet, sepse jep idenë e asaj që ka qenë, aq më tepër për një godinë që ne e shikojmë të gjithë. Është një godinë që është aty dhe ne e shikojmë. (Të thuash për atë godinë, mua më vjen në mendje). Në qoftë se mendojmë për teatro të vjetër ka pa fund shembuj, një që më vjen në mendje është arena e Veronës. Nuk besoj se kur kanë ndërtuar arenën e Veronës kishin parashikuar të gjithë sistemin e zjarrfikësve, banja të

mjaftueshme për të gjithë, sistem ajrimi, kondicionimi, sepse ai është i hapur, kështu që nuk ka sistem ajrimi, por të gjitha infrastrukturat që sot legjislacioni jo vetëm shqiptar, por edhe ai perëndimor, kërkon. Kështu që të arrihet në konkluzionin që nuk restaurohet, është vërtet absurde.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ju lutem, mos e ndërprisni zotin Shehaj!

Agron Shehaj - Kjo e fundit nuk ishte pyetje, sepse qëndrimi juaj është aq absurd, sa nuk e kuptoj ku e gjeni kurajën që të vini këtu. Në fakt, unë e kam një pyetje për ju zotëri: ju lutem, më thoni cilën ndërtesë keni bërë ju, që ta dimë, ku keni punuar, që ta kemi parasysh?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zoti Balliu dhe më pas fjalën e ka zoti Luka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Shehaj – Kjo nuk është tallje! Të vish këtu në komision dhe të thuash nuk restaurohet një ndërtesë, nuk është tallje?!

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Balliu!

Klevis Balliu – Faleminderit!

Shikoj që ka disa ankesa nga maxhoranca, po patët ndonjë shqetësim te portali “Shqipëria që duam”, 3 minuta zgjat, për 10 ditë ju kthen përgjigje ministri përkatës. Kështu që zgjidhni atje ato.

Së dyti, për çështjen e teatrit me gjithë respektin për artistët, dhe e shikoj se ju e keni për zemër, por këtu nuk bëhet fjalë për teatrin, këtu është çështja e korrupsionit dhe e kullave.

Pyetja që unë kam është: ju artistët sa jeni informuar, sepse qeveria ka platformën e bashkëqeverisjes, (nuk e di, e drejton Saimiri akoma, apo e ndërruat atë, sepse ka qenë kryetari i asaj) dhe normalisht duhet t’ju kishte pyetur ju, nuk e di nëse keni bërë ndonjë diskutim paraprak?

Së dyti, kam një pyetje për të gjithë: çfarë pune ka bashkia te çështja e Teatrit Kombëtar, sepse Teatri është çështje e pushtetit qendror? Ky ligj nuk ka kaluar akoma, ndërkohë kompania “Fusha” është zyrtarizuar dhe duhet të ishte negociator në bazë të ligjit, por kompania është futur.

Së treti, a ka ndonjë projekt për sa i përket shpenzimit që mund të ketë për rehabilitimin e Teatrit?

Së katërti, teatri është një pasuri kombëtare për ne, ka histori. Po të bëhet një teatër tjetër, humb ajo histori. A do të ishit kundër ju, sikur tetari atje, qoftë edhe kështu siç është për t'u mbajtur si pjesë e historisë sonë, të ruhej, të rregullohej për të ruajtur atë pjesë të historisë dhe ne të bënim një teatër tjetër, duke hequr qafe atë shëmtinë e Piramidës, sepse ajo është e shëmtuar, nuk ka asnjë funksion, rri aty kot? A do të ishit kundër ju që të ndërtonim një teatër të ri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te “Shqipëria që duam”, atje shko ankohu!

A do të ishit kundër ju që ta bënim këtë teatrin e ri në një vend tjetër dhe këtë ta ruanim si monument kulture, si pjesë e historisë sonë, për të gjithë ato që thatë ju, për të gjithë ata gjigantë të artit, që kanë luajtur rolet e tyre aty?

Gjithashtu, është shqetësues fakti që nuk kemi asnjë lloji informacioni, dhe në qoftë se e kanë kolegët e maxhorancës, të na japin një informacion se sa metra katrorë është teatri sot dhe sa metra katrorë do të jetë teatri më vonë, mbas ndërtimit të 6 kullave. Të na japin informacion për projektin, se sa para do të jetë investimi i projektit, sepse deri tani nuk kemi asnjë informacion, dhe ndërkohë këtu ligjin po e kalojmë, ndërkohë teatrit nesër pasnesër kjo qeveri mund t'i fusë edhe tritolin, se këto u futën tritolin edhe shtëpive të qytetarëve dhe nuk e kanë problem atë pjesë. Kanë vite që e bëjnë këtë si proces, por të jem e sigurtë pavarësisht pyetjeve dhe përgjigjeve që mund të jepni apo dhe debateve të kolegëve të maxhorancës, e vërteta është që këtu ka vetëm një mision; kemi të bëjmë me një Kryeministër, i cili ka disa probleme të tijat dhe kur i fiksohet diçka, nuk di të ndahet. Ky projekt ka 20 vjet, a jeni dakord ju, që një projekt i hartuar para 20 vjetëve të zbatohet sot?

Gjërat tani kanë ndryshuar. Pse duhet të bëjmë të njëjtën gjë që ka menduar ky zotëria para 20 vjetëve? Kjo nuk është normale.

Gjithashtu, nga kolegët e maxhorancës, sepse unë nuk e kam ditur, kam mësuar që ju edhe mund ta shpronësoni këtë për të hapur një konkurs, siç bëtë në rastin e xhamisë. Pse nuk e bëni këtë konkurs për rastin e Teatrit Kombëtar, ku të mund të aplikojnë edhe kompani të tjera, përveç kompanisë Fusha, të cilat mund të propozojnë rehabilitimin e Teatrit? Të jeni i sigurt, zotëri, që rehabilitimi i Teatrit është më i lirë. Kjo qeveri ka para të mjaftueshme për ta bërë, sepse ka harxhuar 570 milionë euro për tapete dhe xhama të ministrive nga paratë e taksapaguesve.

Një këshillë kam: nuk është e nevojshme të na falënderoni ne, që po ju presim ju, sepse ne e kemi për detyrë. Të gjithë siç jemi paguhemi nga ato taksa që paguheni edhe ju. Është kënaqësia dhe nderi ynë të përballemi më në fund këtu, por do të ishte në identitetin tuaj që gjërat t'i thoni as për respekt të njëres palë apo tjetrës, por t'i thoni ashtu siç janë, që këtu nuk ka lidhje Teatri, por një aferë korruptive e një mendje të sëmurë me vese siç është ky që na ka rënë përsipër të na drejtojë sot.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Me sa duket po më vendosni përpara alternativës që të vazhdojmë me diskutime gjatë kohës që bëhet pyetja, apo edhe me pyetje retorike.

Një kërkesë jua kam drejtuar dhe, që ta menaxhoj siç duhet dhe siç rregulli e kërkon, jemi te pjesa e pyetjeve, komente mund të bëjmë të gjithë më pas. Do vazhdojmë me këtë mënyrë, apo do të vazhdojmë me mënyrën tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetje, pra.

Zoti Luka, shpresoj te racionaliteti

Lorenc Luka – I jepni fjalën opozitës, sepse dje ia mohuat fjalën në mënyrën më skandaloze.

Eduard Shalsi – Opozita ka folur gjithmonë më shumë.

Lorenc Luka – Faleminderit për sjelljen që reflektuat ditën e djeshme!

Kam një pyetje për ekspertin e porositur në lidhje me problemin e zjarrfikësve. Më ngjason prononcimi juaj dhe konkluzionet me një vendim, sepse kujtesa historike është shumë e rëndësishme, që është marrë në vitin 69' për shkatërrimin e bezistenit të Shkodrës. Fatkeqësisht, po kthehemi në të njëjtat vite në një kohë tjetër.

Sipas jush, për problematikat që ka zona historike e Shkodrës, e rikualifikuar tashmë, ndër ato objekte është edhe fototeka “Marubi”, nëse do të bënit një relacion, do të shpreheshit që duhet shkatërruar zona historike e Shkodrës? Më duket se për ju rëndësi ka vetëm ajo periudhë e ndërtimeve, që i takon periudhës së 50 viteve dhe periudhës së viteve në pushtet të pasardhësve të Partisë së Punës.

Eduard Shalsi – Shumë faleminderit, zoti Luka! Ishit shumë konciz.

Ka mbetur vetëm zoti Mima, apo...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Mima është i fundit.

Lorenc Luka – Faleminderit!

Kam një pyetje për zotin Lapaj, si jurist dhe person që e kishte studiuar çështjen dhe në vijim edhe të diskutimit që bëri për sa i përket hapave, që kanë menduar. Që kjo është vjedhje me ligj, këtë e dinë të gjithë, por pyetja është konkrete. Duke qenë se Kushtetuta e sanksionon qartë në nenin 113, germa “b”, që ky Kuvend praktikisht nuk mund t’ua heqë këtë të drejtë pronësie këshillave dhe konkretisht këshillit të bashkisë Tiranë, çfarë mendoni për këtë bazë ligjore që po përdor qeveria në relacion dhe që flet thjesht për të drejtë prone, dhe që prona dhurohet ose trashëgohet?

Faleminderit!

Florion Mima – Kërkoj mirëkuptimin tuaj, sepse të katërta pyetjet i kam me zotin Bojaxhiu. Që të mos fillojmë përgjigjen me zotin Bojaxhiu, në respekt të kolegëve, të fillojnë ata me përgjigjet e pyetjeve të tjera dhe unë më pas të bëj pyetjet e mia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ju lutem në mënyrë sa më koncize. Meqenëse inxhinier Hysenlliu është i përqendruar, po e filloj me të dhe pastaj sipas radhës.

Agron Hysenlliu – Faleminderit për pyetjet dhe komentet!

Së pari, unë nuk ia kam borxh askujt nga këta zotërinjtë të nderuar të më fyejë dhe të më prekë në integritetin tim.

Unë kam ardhur këtu si inxhinier dhe jo të më tregoj njeri rrogën. Nëse ka dikush konflikt me rrogën, jeni ju, zotërinj, jo unë. Unë jam inxhinier. E dyta, dua t’i bëj me dije zotërisë se unë jam një projektues dhe kam ndërtuar 40 objekte, kam mbrojtur dy masterë për strukturat e holla të betonit, kam ndërtuar objekte në Tiranë, që nga Spitali Gjerman...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kërkoi zotëria.

Eduard Shalsi – Ka mundësi, zoti Bumçi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, mos i kthe përgjigje.

Zoti Hysenlliu keni punë me mua.

Cilido nga kolegët që do fjalën, le të ngrejë dorën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka mundësi?

Hodhët dyshime dhe një pyetje ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ta kam dhënë fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po flas unë, prandaj mbylle mikrofonin.

Me shumë të drejtë, disa prej jush, përpos pjesës që realisht ishte ofendim, kërkuan një cv për të ditur çfarë ka bërë zotëria.

Florion Mima – Nuk e kërkoi askush këtë. Mos provoko.

Eduard Shalsi – E kërkoi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ta kam dhënë fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është racionale të pyesni çfarë ka bërë. Po e shpjegon. Nuk e bëtë ju, por kolegu juaj. Do ta lëmë të përgjigjet apo...? Doni apo jo përgjigje?

Eduard Shalsi – Nuk do t'i kthesh përgjigje njeriu tjetër.

Florion Mima - Duhet sqaruar kjo. Nuk mund të na lësh përsipër një gjë...

Eduard Shalsi – E tha ai tjetri.

Eduard Shalsi – Ndërpritet seanca. Ju kërkoj ndjesë!

Ju faleminderit për përgjigjet e pyetjeve. Me sa duket ...

Klevis Balliu – Pse e prishni mbledhjen? Të marrim përgjigjet e pyetjeve. Të lutem shumë, me qetësi të marrim përgjigjet e pyetjeve që bëmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Hysenlliu – Po vazhdoj për pyetjet...

Eduard Shalsi – Nuk do të vazhdosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Mundësia dhe shansi i fundit. Nëse do ta ndërprisni, e mbyllim mbledhjen. Nëse ky është qëllimi, e mbyllim mbledhjen. Shansi i fundit.

Agron Hysenlliu – Pyetja e parë: nga kush kam marrë urdhër dhe a kam gjykuar si inxhinier apo me urdhër?

Unë kam 35 vjet që punoj si inxhinier i pavarur dhe në punën time nuk përfaqësoj...

Unë këtu përfaqësoj Institutin e Ndërtimit mbi bazën e një pune të bërë nga 11 inxhinierë. Me këta inxhinierë profesionistë të moshës sime me thinja në kokë kemi bërë një punë profesionale për t'u ardhur në ndihmë si qytetarëve, ashtu edhe artistëve që janë në atë ambient. Ne kur themi që aty nuk ka kushte ...

Unë nuk jam politikan, por inxhinier. Që atje nuk ka kushte, e thonë artistët. Unë kam një material *power point*, të cilin nëse do të mund t'jua tregoj këtu, do t'ju bind të gjithëve që atje nuk ka kushte. Nuk e kam bërë publik. Kam një relacion legal të firmosur. Në këtë aspekt unë nuk i shërbej askujt, por mirëqenies së njerëzve, sipas ligjit. Jam inxhinier që kam punuar për 35 vjet privatisht. Kam 40 objekte të miat, kam në Maqedoni dhe në Kosovë. Kaq për veten time.

Për sa i përket çështjes që objekti nuk plotëson kushtet teknike, kjo nuk ka të bëjë vetëm me zjarrin, siç tha zotëria, sepse zjarri është një nga aspektet. Ngrohje-ventilimi është një nga aspektet, elektriciteti, që këtu nuk u përmend fare, është një nga aspektet, por problematika më e madhe është tek infrastruktura dhe konstruksioni.

Në qoftë se do të keni durim të më dëgjoni si inxhinier, ju lutem vetëm tre minuta kohë.

Objekti tjetër ka qenë ngrehinë e lehtë. Ngrehinat e lehta nuk llogariten për peshë, por për erë dhe borë. Në objektin e vjetër është bërë një çarje në mes, që ne e kemi argumentuar, nëse do të lexoni relacionin, ku është vendosur një godinë elastike me blinda. Për efekt të uljeve diferenciale që ka pësuar kjo godinë, të gjitha themelet e ngrehinës së lehtë janë ngritur dhe kanë ceduar. Në këtë aspekt ka ndodhur fenomeni i bulbës së qepës, kur ushtron një forcë, krijohet një bulbë. Duke ngritur këto themele, ato janë çarë. Ne i kemi evidentuar. Njëkohësisht janë ndërtuar edhe dy volume të tjera anësore, që janë të këtij karakteri, që llogariten për efekt sizmik. Në rast tërmeti, këto tërmete japin amplituda dhe frekuenca të ndryshme. Unë nuk doja të flisja me këtë gjuhë, që as zonja arkitekte nuk e di, sepse nuk është konstruktore, por arkitekte.

Problematika është që edhe objektet e ndërtuara pas Teatrit Kombëtar kanë bërë ulje diferenciale të tyre dhe kanë dhënë problemin e tërheqjes së objektit të vjetër. Si rezultat kanë dhënë çarje në këto objekte. Të gjitha këto sjellin riskun që ne u japim këtyre. Po, ju ka ruajtur 0,81%-i, në gjuhën teknike. Kush ka mend në kokë, le të gjykojë. Ne kemi dhënë sinjalin e alarmit që të mos i fusnit njerëzit aty brenda.

Këtu nuk bëhet fjalë për të shtruar disa tuba, që nuk ke ku t'i shtrosh, sepse nuk ka tavane. Tavanet po mbahen me hekur sepse janë duke rënë. Ai objekt nuk rikonstruktohet në koncept, sepse po të bëhet, do të prishet i gjithi, sepse nuk ka skelet. Kush ka njohuritë fillestare nga ndërtimi, e di shumë mirë. Është rikonstruktuar Ministria e Zhvillimit Urban, por është me mur tulle, kurse godina e Teatrit nuk ka skelet. Është rikonstruktuar Kryeministria, por ka skelet, mure, janë bërë mbajtje me hekur, janë shtuar betone për ta mbajtur.

Kështu që, në këtë aspekt Teatri nuk mund të qëndrojë. Rikonstruktohet edhe ndryshe, duke e prishur të gjithin dhe të ndërtohet në gjurmë. Po u ndërtua në gjurmë, nuk plotëson asnjë kusht arkitektonik. Po vij te zanati i zonjës, sepse të banosh në një ambient ku janë vetëm dy banjo dhe njëra banjo është kthyer në lavanteri, ky nuk është standard. Ne jemi në vitin 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni për tonin, por ndihem tepër i acaruar në kuptimin e mirë të fjalës!

Problematika tjetër është se ajo pjesë është politike. Unë e thashë, nuk jam politikan, jam inxhinier. Kur të bëhem deputet, ndoshta edhe unë do të flas si këta zotërinjtë, por unë jam inxhinier, jam në zanatin tim dhe nuk jam rrogëtar i shtetit, zonjë!

Në vitin 2014 më kanë emëruar në Institutin e Ndërtimit, që e kam marrë me 700 milionë minus nga ju, dhe kam ndërruar mentalitetin, kam ndërruar të gjithë mundësinë e atij institucioni, duke e çuar në 1 miliard plus.

Përplasni duart, por është e vërtetë! Jam shumë i nderuar që e them në këtë institucion! Prandaj, në këtë aspekt kam bërë punën time si inxhinier, si qytetar, jam qytetar i Tiranës, emocione për Teatrin kam unë më shumë sesa ti, sepse ti je e ardhur, ndërsa unë kam parë teatro atje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të më falni, por edhe unë kam emocionet e mia!

Eduard Shalsi – I kuptoj emocionet në bazë të atyre që ju thoni...

(Kryetari i komisionit dhe zotëria flasin njëkohësisht.)

Agron Hysenlliu – Nga ana teknike, këtu nuk ka të bëjë vetëm me një zjarr, me një ujë dhe me një ngrohje, këtu ka të bëjë me strukturat e objektit.

Eduard Shalsi – E qartë.

Agron Hysenlliu – Të kem një inxhinier përpara, le të jetë i krahut andej matanë, të vijë këtu të sqarohet me mua, t'ia shpjegoj nga ana teknike, sepse, zotërinj të nderuar, ky panel nuk është për mua. Unë jam profesor i fushës.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, do të vazhdojmë me pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kishit një pyetje.

Neritan Liçaj – Unë jam rrogëtar dhe nuk e kam për turp, siç jemi të gjithë, sepse të gjithë paguhemi nga taksapaguesit dhe i shërbejmë taksapaguesit. Prandaj nuk e kuptova pse zotëria e mori për fyerje.

E para, të gjithë jemi rrogëtarë.

E dyta, nuk është e vërtetë fare se ka gjendje emergjence.

Që para...

(Mungesë regjistrimi)

Eduard Shalsi – Ndizeni pak mikrofonin, të lutem!

Neritan Liçaj – Që para njëzet vjetësh na erdhi një arkitekt nga Franca që tha po të njëjtën këngë, që ky do të bjerë, ky do të shembet. Jo, jemi aty!

Sa për dijeni, pati përmbytje, u përmyt Biblioteka, u përmyt Bashkia, ndërsa gropa e Teatrit Kombëtar nuk u përmyt.

Miq tanët, inxhinierë, më thonë se struktura e betonit, sepse, të shkretët ne, jemi bërë edhe specialistë, i reziston edhe armës atomike! Ata shtojnë se teknologjia tani ka arritur aq mirë sa pa i prekur asgjëje, Teatri Kombëtar bëhet kungull. Megjithatë, le t'i lëmë diskutimet. Sillni nga BE-ja një grup ekspertësh të pavarur! E keni për detyrë për Teatrin Kombëtar, madje e kemi, se nuk po e përjashtoj veten!

Atje nuk bie era qofte! Në qoftë se ndonjëri nga ju do të vinte të punonte në atë Teatër për një javë, do të binte në dashuri dhe nuk do të donte kurrë të ikte nga ai vend! Ju nuk e keni idenë sa dashuri e madhe është ai vend. Unë kam 25 vjet, çerek shekulli, po shkoj 50 vjeç tani, dhe është i vetmi vend ku shkoj dhe ndihem si në shtëpinë time, ku përqafoj dy djemtë e mi. Si kujtoni ju se unë do të rrezikoja kokën time dhe jetën e atyre dy fëmijëve të shkoja në një vend të pasigurt? Jo, është i sigurt! Të jeni të bindur, është shumë i sigurt!

Unë po ju them një gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, jeni deputetë të popullit, më shikoni në sy!

Kam nderin të jem para jush, por edhe një gjë të fundit: nuk vritet nëna, sepse është plakë! Çdo njeri prej nesh do të shkonte të merrte kredi ta çonte nënën në spitalin më të mirë që t'ia zgjaste jetën!

Kaq kam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Jo, thashë që ta merrje një herë fjalën dhe pas pyetjeve të zotit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të dy.

Atëherë, e ka fjalën avokati dhe vazhdon zoti Merxhani, arkitekti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me mikrofon, ju lutem!

Adriatik Lapaj – ...u mundova t'i nxirrja tani për të qenë korrekt edhe me kuadrin ligjor.

Në lidhje me pyetjen: “Çfarë mendoni për procedurën që po ndjek qeveria për tjetërsimin e pronës publike? A është ajo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi?”, në bazë të germës “b” të nenit 113 të Kushtetutës, ku thuhet: “Këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarkut ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyrë të pavarur të ardhurat e krijuara”, të drejtën për pronat që janë në varësi të njërive vendore e kanë vetëm njësitë vendore sipas Kushtetutës.

Sipas pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës, ligji “Për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes vendore”, që rregullon pronat e qeverisjes vendore, pra tjetërsimin dhe përdorimin e pronave të vetëqeverisjes vendore, është një ligj organik, që miratohet me tre të pestat (me 84 vota).

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (pra lidhur me të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë) thuhet: “E drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër”. E ka detyrim ligjor, nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte asnjë subjekti tjetër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këshillat vendorë.

Në germën “e” të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” thuhet: “Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca: “Miraton tjetërsimin ose vënien në përdorim të pronave subjekteve të treta”.”

Shkojmë te neni 55 i ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili thotë: “Këshilli bashkiak, në çdo rast, miraton me shumicë të cilësuar tjetërsimin e pronave të tretëve”. Pra, ne kemi sot në fuqi, i nderuar zoti deputet, për t’u përgjigjur, një kuadër të plotë ligjor, duke filluar nga Kushtetuta, te ligji organik, te rregullorja e Bashkisë së Tiranës, i cili rregullon këtë marrëdhënie juridiko-civile për palët që janë në këtë proces.

Nuk duan ta respektojnë kuadrin ligjor të miratuar ndër vite, por duan të bëjnë një bajpas, me një ligj të posaçëm, i cili miratohet, siç e thashë, nga një shumicë e thjeshtë, pra me gjysmën e gjysmës. Nëse do të vendosim standardin e ligjeve që bëhen me porosi për subjekte të posaçme, të jeni të bindur se precedenti është i rrezikshëm pasi sot Kryeministër është Edi Rama, sot kryetar është zoti Shalsi, por do të ikin, sepse po të ishin të përhershëm, nuk do të ishte zoti Shalsi, kjo është e sigurt! Edhe në jetë nuk jemi të përhershëm. Por do të vijë një kryeministër i radhës, dy, tre, katër, që këtë precedent mund ta kthejë në një precedent edhe më të rrezikshëm, nëse këta nuk kanë kohën e mjaftueshme për ta bërë baltë. Sepse të vendosësh këtë standard, ku godinat shtetërore merren me procedura të jashtëzakonshme...

Pra, ne mblidhemi në këtë situatë... Artistët nuk kanë statusin! Kjo është emergjenca e artistëve, të bëjnë statusin. Ndërkohë emergjenca qenka për të bërë një ligj të posaçëm për...

Po e mbyll këtu për të mos u zgjatur, se edhe ju keni angazhimet tuaja, unë mendoj se ju, si përfaqësues të popullit, të paktën një herë të vetme, more për një çështje, pse nuk e çoni vendimmarrjen te qytetari? Sepse kjo është një vendimmarrje që, në fund të ditës, mund të ndahet shumë thjesht te qytetari.

Përse duhet ta mbani ju barrën e provës për një gjë që vjen në kundërshtim me ligjin? Kemi një kuadër të plotë ligjor, por nuk po e respektoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e mbyll.

Edhe me ligj ju mund të mblidheni të shkrini Ushtinë, nuk është ndonjë çudi e madhe! Mund ta ndryshoni Kushtetutën sa herë të doni, po të bëni votat, se jo çdo gjë që shkruhet në ligj është e moralshme!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Merxhani!

Kreshnik Merxhani – Faleminderit!

Po bëj një parahyrje. Dua të sqaroj se proceset e konservimit dhe të restaurimit prekin edhe konstruksionin dhe, së fundi, duke qenë se Europa ka një stok të madh të objekteve të periudhës moderne, prekin edhe restaurimin, rehabilitimin dhe rivlerësimin e konstruksioneve beton-arme ose çfarëdolloj konstruksioni tjetër, duke u nisur edhe nga ato metalike. Pra, restaurimi i çdo lloj strukture është krejtësisht i plotë dhe i mundur, sikurse ne e dimë shumë qartë këtë.

E rëndësishme është të dimë cili është fokusi. A duam ta restaurojmë? Pra, a do ta mbledhim të gjithë talentin, a do t'i mbledhim të gjitha financat, të gjitha energjitë dhe të gjitha kapacitetet për ta restauruar, apo duhet të gjejmë argumente, të cilat, në rastin e raportit të Institutit të Ndërtimit, i cili duhet të jetë edhe publik (dhe të na bëjë të qartë se ku i ka bërë analizat laboratorike apo edhe sondazhet për të vërtetuar çarjet në themele), jo teorikisht, por duhet të na e vërtetojnë këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, shqetësimet për gjendjen ekzistuese i gjejmë të drejta, sepse edhe ne shqetësohemi për gjendjen ekzistuese, për degradimin që ka objekti, sepse nuk është vënë dorë, por nuk i gjejmë kurrë si arsye për të rrënuar, për të tjetërsuar apo për të eliminuar një monument të jashtëzakonshëm të trashëgimisë kulturore, siç është Teatri Kombëtar, dhe këtë duhet ta ndajmë nga gjuha politike. Kjo është një gjuhë krejtësisht profesionale qytetare, që na prek të gjithëve. Ky është një precedent që mund të na kthehet në shumë forma.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të mos folur për raportet konstruktive të të gjitha ndërtimeve pa leje që po legalizohen. A janë këto në përputhje me kodet e kështu me radhë? Pra, nuk është kjo arsye për të eliminuar ose për të paraqitur prishjen e Teatrit Kombëtar.

Në qoftë se ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në pjesën e restaurimit ne nxjerrim disa kosto, po themi, të përafërta kur nuk ka një projekt dhe unë nuk e solla pa qëllim shembullin e Muzeut dhe fototekës “Marubi”, që ishte një objekt krejtësisht i degraduar.

Sipas të dhënave zyrtare të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, por edhe të zyrave të projektimit, ai objekt është pak më shumë se 1300 metra katrorë dhe ka kushtuar 1,5 milionë euro, ndërkohë që Teatri Kombëtar është 1200 metra katrorë dhe, në qoftë se ne do t'i vëmë edhe dyfishin, qoftë edhe trefishin apo edhe katërfishin për ta rehabilituar, sepse rehabilitimi dhe restaurimi, pra siç e thashë, nuk janë vetëm në nivel objekti, se mund të vijë edhe rehabilitimi dhe restaurimi në nivel urban, meqenëse aty kemi një ansambël arkitektonik, mund të prekë edhe objektin tjetër dhe përsëri të mos kalojmë shifra, po themi, apriori, pa dashur të abuzoj me fjalën, mbi 10 milionë euro apo qoftë edhe 15, por përsëri janë shifra të përballueshme.

Nga ana tjetër, ka një studim që është bërë nga studentët e Universitetit Politeknik të Barit, por është i keqpërdorur, për fat të keq, dhe këtu po përmend pupulitin, me të cilin nuk mund të bëhen struktura, por është vetëm veshës (duhet t'i themi këto), i cili propozon restaurimin e Teatrit Kombëtar dhe kthimin e pjesës së Teatrit Eksperimental, duke e ruajtur pjesërisht dhe duke i dhënë Tiranës një muze të kryeqytetit, të munguar; të munguar dhe të kërkuar; të kërkuar edhe në planin e përgjithshëm vendor, në kuptimin që Tirana nuk ka një vend ku mund të dëshmojë, nëpërmjet një monumenti të vetëm, të gjithë historinë politike dhe artistike të shtetit të ri shqiptar dhe, nga ana tjetër, edhe historinë e vetvetes.

A është një projekt, një projekt-ide? Mund të përpunohet vetëm nëse punohet në këtë drejtim dhe vetëm në këtë drejtim!

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Atëherë, rezervon të drejtën e fjalës zoti Bojaxhiu për pyetjen që kishte njëri nga kolegët, por do të dëgjojmë edhe pyetjet e zotit Mima dhe pastaj do ta marrë fjalën për përgjigjet.

Po, zoti Mima.

Florjon Mima – Ju falënderoj, zoti Shalsi!

Zoti Bojaxhiu, ju drejtohem për një set pyetjesh, që nga fushëveprimi janë afër aktivitetit tuaj të mëparshëm dhe formimit tuaj Perëndimor.

Në dijeninë dhe në opinionin tuaj, përse qeveria nuk hap konkurs ose garë ndërkombëtare për rastin në fjalë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sugjeroj të procedojmë kështu: unë t'ju bëj pyetjen, ndërsa ju të më jepni përgjigjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjergj Bojaxhiu – Në fakt, çështja e konkursit është diçka për të cilën mendoj se Tirana ka nevojë. Zhvillimi i qendrës urbane dhe historike të Tiranës ka shumë nevojë dhe është një standard që po u mohohet qytetit dhe qytetarëve të Tiranës.

Duke mos bërë konkurs, ne praktikisht e kemi konturuar debatin në mënyrë të qëllimshme dhe fatkeqësisht për qytetin në dy kampe, nuk po them ekstreme, por në dy kampe: ose do të bëhet teatër i ri, ose do të rrimë me një karakatinë.

Në fakt, duke bërë konkurs ndërkombëtar, qytetarët e Tiranës dhe ju, si politikëbërës, të gjithë do të kishim mundësinë që të shikonim nga profesionistë të mirëfilltë, që punojnë dhe kanë përvoja të ngjashme në të gjithë botën, apo edhe të na jepnin ide dhe alternativa se si ne mund të integrojmë ruajtjen e historisë dhe të trashëgimisë, vënien në ambiente më moderne dhe më operative, më të mira, për aktorët dhe për artistët. Gjithashtu, ka një gamë, një ylber këtu në mes, të alternativave që mund të na ofroheshin.

Duke mohuar mundësinë e një konkursi ndërkombëtar, ne detyrohemi të mbajmë qëndrime dhe të pozicionohemi në kampe edhe ekstreme, dhe debati pastaj përfundon në zhurmë.

Në fakt, përtej marrëveshjes famëkeqe, dhe mënyrës se si u shit në opinionin publik, që disa aktorë dhe artistë bënë me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, e vërteta është se një nga kushtet që këta aktorë dhe artistë i kanë kërkuar kryetarit të Bashkisë së Tiranës është të mos bëhet asgjë pa konkurs ndërkombëtar. Sepse edhe komuniteti i artistëve, përtej opinionëve të ndryshme që ka, është i qartë për një gjë: ata nuk janë çuar thjesht për karrigen dhe skenën e tyre, ata janë çuar edhe për qytetarinë.

Do të ishte shumë e ulët nga ana e tyre të kërkonin vetëm pjesën e tyre, si aktorë, dhe çfarë benefitesh do të merrnin, jo në kuptimin personal, por edhe si komunitet, po të mos e çanin kokën për interesin e qytetarëve dhe transparencën. Kështu që, fakti se në këtë projektligj nuk është vendosur elementi i konkursit ndërkombëtar, përbën në vetvete edhe shkeljen e së ashtuquajturës marrëveshje.

Po të shikonim daljet televizive edhe të zotit Basha, edhe të zotit Derhemi pas marrëveshjes, të dy kanë përmendur qartë se një nga kushtet e prezantuara, dhe që është pranuar nga kryetari i Bashkisë, është një konkurs ndërkombëtar.

Ky konkurs mungon në projektligj edhe sikur të linim të gjitha bisedat paraprake që ne bënim. Kështu që, në vetvete nuk mund të ketë marrëveshje me komunitetin e aktorëve pa pasur

një garë të hapur, ku ne të gjithë të dimë se cilat janë alternativat jo nga pozicionimet politike, jo nga punonjës të shtetit që paguhen nga shteti, ndoshta as edhe nga profesionistë të lirë, por që nuk punojnë dot në profesionin e ndërtimeve pa pasur të bëjnë me lejet nga shteti dhe me konkurset nga shteti.

Kështu që, një konkurs ndërkombëtar në minimum, cilido të ishte rezultati final, edhe sikur të përfundonim me të njëjtin projekt, do të ishte një proces që, si proces, do të legjitimonte këtë gjë që ne duam të bëjmë në qendër të Tiranës dhe të paktën do të dinim si të komunikojmë me njëri-tjetrin në të ardhmen.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Po, zoti Mima.

Florjon Mima – Faleminderit!

Pyetjen e dytë, zoti Bojaxhiu, ia kam drejtuar dje ministres së Kulturës, e cila ka qenë e ulur në vendin tuaj dhe ishte një pyetje shumë naive: “Nëse shteti do të kishte para, a do të lejonte që të përfshiheshin privatët me vetofrime të tilla?” Përgjigjja nga ministrja ishte e prerë: “Jo, nëse do të kishte para, këtë punë do ta bënte vetë shteti”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qoftë rinovimin, rehabilitimin apo ristrukturimin, quajeni si të doni, qoftë rrafshimin dhe ngritjen e një godine të re në të njëjtën gjurmë. Pra, këtë punë do ta bënte vetë shteti.

Ju bëtë thirrje për gjeste filantropike. Unë nuk jam kundër, por që t’i afrohem më shumë formimit tuaj: a ka mundësi të tjera financimi, me instrumente financiare nga më të ndryshmet, që po dalin çdo ditë sot, që janë pa kosto dhe nuk e rrisin borxhin dhe deficitin e këtij shteti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjergji Bojaxhiu – Pa dyshim, unë do të thosha se mundësitë financiare të shtetit shqiptar ekzistojnë dhe, pa dyshim, ju, si ligjvënës, miratoni një buxhet dhe vendosni ku duhet të jenë prioritetet dhe si duhen shpenzuar fondet.

Kam përshtypjen se për vitin 2018, domethënë në fund të vitit 2017, kur ju votuat buxhetin e këtij viti, juve nuk ju është dhënë apo prezantuar alternativa që një pjesë e fondeve të buxhetit do të kalonin ose jo për rehabilitimin e Teatrit apo për një teatër të ri. Kështu që, nisur nga fakti se kjo alternativë nuk ju është paraqitur për diskutim, mendoj se në vetvete është diçka që ju e ndieni se është mungesë dhe sot përballemi me një artificë.

Gjithsesi, dua të them se vetëm me konfiskimet që shteti shqiptar po bën, dhe shumë mirë që po i bën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me godinat që janë në pronësi të atyre që janë marrë me pastrim parash, me tregti e trafik droge, apo edhe me ato që mund të jenë kapur ditët e fundit në doganë, dhe shumë mirë që janë kapur, Policia e Shtetit është për t'u vlerësuar, unë mendoj se ka fonde për ta rehabilituar Teatrin.

Ajo që mendoj se mungon këtu është qartazi një vullnet për të pasur dhe për t'i konsideruar të gjitha alternativat.

Fatkeqësisht për ne, këtu është nisur një tren që në fillim në një drejtim të caktuar dhe ky tren nuk pranon alternativa. Madje arsyeja pse ka një irritim nga shoqëria civile është sepse i gjithë debati sillet rreth faktit se ky tren po ecën dhe ne duhet ta ndalojmë; nuk ka asnjë alternativë tjetër.

Florjon Mima – Pyetja e fundit, zoti Bojaxhiu, lidhet me tri ndërtesat në gjithë këtë kompleks të madh kulturor dhe historik, që ne e përdorim në zhargon “Bulevardi i madh” (me të gjithë aksesoret e tij), të cilat janë ndërtuar në kohën e komunizmit dhe që e kanë vrarë dhe shëmtuar në mënyrë permanente atë. Çfarë mendimi keni ju për mbajtjen ose jo gjallë të këtyre “kufomave”, të këtyre “dinozaurëve” të komunizmit, siç janë: Piramida, Pallati i Kulturës dhe Muzeu Historik Kombëtar.

Gjergj Bojaxhiu – Si Forum i Trashëgimisë Kulturore, ne kemi qenë konsistentë në mënyrë të vazhdueshme në qëndrimet tona. Po marr në mënyrë të veçantë çështjen e bisedës për Piramidën, se ka qenë mbase simbolikë më e fortë e këtij debati, të cilit ju po i referoheni. Forumi Trashëgimisë Kulturore ka menduar dhe vazhdon të mendojë se Piramida duhet ruajtur, pavarësisht se kujt epoke i përket. Në këtë këndvështrim për ne, nuk ka rëndësi emërtimi i epokës (fashiste, komuniste, zogiste etj.). Objektet që kanë një identitet, një vlerë, një histori për qytetin në çdo konteksti politik, duhen ruajtur.

Të mos harrojmë se edhe italianët, kur erdhën dhe ideuan sepse një pjesë u bë në kohën e Zogut dhe një pjesë u bë nga Italia fashiste, u përpoqën në maksimum që identiteti i ri, të cilin donin t'i jepnin Tiranës të mos mbivendosej mbi identitetin e mëparshëm.

Kemi edhe shumë raste, kur vetë regjimi komunist përtej kishave dhe xhamive (megjithëse e ruajti Xhaminë në qendër), objektet kulturore, stadiumin e vjetër nuk e prishi, por

bëri një stadium të ri, nuk e prishi Bibliotekën e vjetër, por bëri një Bibliotekë të re, nuk e prishi Operën e vjetër, por bëri një Opera të re.

Ne mendojmë se edhe një sistem që ishte tërësisht ideologjik, nuk e prishi në këtë masë identitetin e mëparshëm të qytetit dhe të vendit.

Është fatkeqësi që ne sot ta çojmë më tej dhe ta prishim edhe këtë vepër. Opinioni publik qartë, përtej çdolloj gjëje, sepse unë kam opinionin tim. Mua më duket më shumë si vullnet i qeverisë sesa kërkesë reale e një privati. Duket sikur në këtë rast, po e prishim këtë më shumë për pazare të vogla dhe jo për ideologji, domethënë po e degradojmë atë si qëndrim.

U bënë disa pyetje nga kolegët e tjerë dhe nuk pata mundësi t'u përgjigjem. Shumë shkurt, në lidhje me emergjencën, nuk ka asnjë emergjencë që ky ligj të bëhet me procedurë të përshpejtuar.

Unë kam pasur nderin t'u shërbej qytetarëve shqiptarë edhe si zëvendësministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Kam qenë në një sallë relativisht të ngjashme në mbledhjen e KM-së, kur është bërë diskutimi dhe vendimi për Rrugën e Kombit. E them me krenari atë që po them edhe këtu sot. Rruga e Kombit ishte një rrugë me rëndësi kombëtare dhe jo emergjencë kombëtare dhe nuk duhej bërë pa tender. Edhe ky ligj mund të bëhej, pavarësisht se unë kam mendimin tim se çfarë duhej bërë, por Teatri Kombëtar nuk është emergjencë kombëtare. Ai është një objekt me rëndësi kombëtare dhe nuk ka asnjë arsye për t'u përshpejtuar.

Në lidhje me Institutin e Ndërtimit, që më pyeti zoti Shehaj, thjesht për po i përgjigjem shkurt. Do të citoj, se fatkeqësisht qeveria dhe institucionet nuk ju kanë prezantuar as juve, as opinionit të gjerë të gjitha opinionet e ekspertëve, që ka kërkuar. Ajo ka dashur t'i mëshojë dhe të vendosë para kamerave opinionin e disa ekspertëve (edhe të brendshëm dhe ka mbajtur të fshehur, edhe për veten e vet, opinionin e disa ekspertëve të tjerë.

Do t'ju citoj konkluzionin e një prej këtyre opinioneve që qeveria dhe bashkia e kanë marrë dhe nuk jua kanë bërë publik. Po e citoj fjalë për fjalë: "Konkluzion. Mendojmë se pavarësisht sa më sipër, objekti duhet t'i nënshtrohet një studimi më të thelluar tekniko-inxhinierik me instrumentet dhe provat laboratorike për të vlerësuar me saktësi qëndrueshmërinë dhe sigurinë e tij." Është ajo që tha edhe zoti arkitekt.

Në fakt, ju këtu jeni duke konsideruar të fusni dikë në varr, pa ardhur doktori i mirëfilltë dhe pa firmosur me analiza dhe me prova, që ky objekt me të vërtetë duhet varrosur. Kjo për mendimin tim, ngre shqetësimin që ne të shoqërisë civile e kemi (edhe ju e keni) për integritetin

e institucioneve publike. Dua t'ju vë në dukej se vetëm Ministria e Kulturës gjatë këtyre viteve ka vendosur dhe ka hequr nga lista e monumenteve të trashëgimisë kulturore me dhjetëra objekte.

Më vjen keq, por në Tiranë një institucion i tillë dhe të tillë ekspertë, nuk meritojnë më besimin tonë. Fatkeqësisht për ne, se nuk është për t'u krenuar kjo gjë.

Për ta mbyllur, unë mendoj se ka akoma kohë që ky proces të ndalet, jo në kuptimin për të fituar një palë politike apo një tjetër, por t'u jepet një tjetër mundësi qytetarëve të Tiranës që me një konkurs ndërkombëtar, të kemi realisht mundësi të zgjedhim alternativat, që ofrojnë përvojat më të mira në Europë dhe në botë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Kam unë disa pyetje për të cilat do të doja përgjigje shumë të shkurtra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të përgjigjemi të gjithë pastaj, se jemi te pjesa e pyetjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te konkluzionet do t'jua jap unë fjalën, pa problem.

Një sekondë! Kërkesat vlejné për të dy krahët, zoti Shuli, edhe për djathtas edhe për majtas.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua jap unë fjalën.

Keni kërkuar një material shumë voluminoz për historikun e të paktën 25 vjetëve të fundit, në lidhje me kërkesat, korrespondencën me Institutin e Monumenteve të Kulturës.

Pyetja ime e parë zoti Bojaxhiu, është për ju. Sa kohë ka fondacioni juaj, që është krijuar dhe po vepron?

Gjergj Bojaxhiu - Forumi i Trashëgimisë Kulturore është një grupim qytetarësh të angazhuar i cili është organizuar në mënyrë më kolektive prej rreth 7 vjetësh, sepse gjithmonë ka pasur individë që kanë folur.

Eduard Shalsi – Pra, ka 7 vjet që ka aktivitet.

Gjergj Bojaxhiu – Po, kemi 7 vjet që ushtrojmë aktivitet.

Eduard Shalsi - Përse në nuk ka asnjë kërkesë të vetme të depozituar në Institutin e Monumenteve të Kulturës, ndërkohë që ka individë, shoqata apo OJQ të ndryshme, që kanë kërkuar që objekte të ndryshme të futen në monumentet e mbrojtura? Nuk rezulton, të paktën në 20 vjetët e fundit, të ketë një kërkesë të vetme për mbrojtur dhe për të trajtuar godinën e Teatrit si monument kulture. Përkundrazi, ka 3 raporte, të cilat nuk e trajtojnë fare si godinë me vlera.

Ju, gjatë kohës që keni fondacionin, a keni depozituar ndonjë një kërkesë për godinën e Teatrit? Përgjigja të jetë e shkurtër pa dhënë detaje, me po apo me jo.

Gjergj Bojaxhiu – Nuk e kemi depozituar, sepse nuk do të na shkonte kurrë në mend një çmenduri e tillë për ta shembur Teatrin Kombëtar.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – E qartë. Arsyeja pse, është gjë tjetër.

Ju keni qenë titullar i lartë (zëvendësministër Financash dhe drejtor i një korporate), po ashtu, edhe zoti Mima. Gjatë aktivitetit tuaj publik, a ka ndonjë dokument që të tregojë shqetësimin tuaj real në lidhje me këtë objekt dhe çfarë mund të bëhej me të?

Gjatë kohës që qenë titullar i lartë, a ka ndonjë gjurmë, ku ju mund të dëshmoni kontributin tuaj sado modest në lidhje me Teatrin?

Gjergj Bojaxhiu – Nuk ka as gjurmë që ne të kemi kërkuar të ruhet Kalaja e Krujës apo ajo e Gjirokastrës, sepse siç e thashë, është e pamundur që një individ apo një grupim të shkruajë dhe të kërkojë për çdo objekt që ka vlerë në Shqipëri.

Ne në radhë të parë po kërkojmë të mos merren vendime në mënyrë kaq të njëanshme dhe kaq politike. Një shoqëri e suksesshme...

Eduard Shalsi – E qartë. Jo, mos u lodhni kot zoti Bojaxhi, se pyetja ime ishte shumë e thjeshtë: Në lidhje me Teatrin, gjatë kohës që keni qenë titullar, a keni bërë ndonjë kërkesë?

Gjergj Bojaxhiu – Si titullar, nuk kam pasur ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shalsi,

Eduard Shalsi – Nuk kam asnjë problem me përgjigjet tuaja, mund të thoni po, mund të thoni jo.

Gjergj Bojaxhiu – Absolutisht, jam i gatshëm t'ju përgjigjem me kënaqësi. Si titullar i institucioneve që kam drejtuar, kam pasur angazhimin maksimal (siç mbase e keni edhe ju), që të

përqendroj vëmendjen te detyra që më është dhënë nga publiku dhe nga qeveria për ta ushtruar sa më mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si qytetar i angazhuar, brenda mundësive dhe kohës që kam, kam shprehur gjithmonë shqetësimet tona, në lidhje me prekjen e objekteve që kanë rëndësi historike kudo në Shqipëri. Nga ky këndvështrim, siç e thashë...

Eduard Shalsi – Por e keni bërë pa letër të shkruar, pa gjurmë?

Gjergj Bojaxhiu – Nga ky këndvështrim, nuk na ka shkuar kurrë në mend që dikush do të çohet dhe të thoshte se do të prishte Teatrin Kombëtar.

Eduard Shalsi – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Merxhani! Do t’ju jap unë fjalën.

Mos u prekni nga virusi i të folurit pa radhë!

Ka një normë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni shumë të drejtë! Ndoshta mund të keni emocione dhe arsye për të folur, por po të ngrini dorën, nuk do t’ju privoj.

Zoti Liçaj, kam një pyetje për ju.

Unë kam qenë zëvendëskryetar i Bashkisë së Tiranës, kur kemi iniciuar projektin për Metropolin.

A patët mundësi ta vizitoni mjedisin e ArTurbinës?

Neritan Liçaj – E kam parë para se të inaugurohej.

Eduard Shalsi – ArTurbinën?

Neritan Liçaj – Po, ArTurbinën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Çfarë mendimi keni?

Neritan Liçaj – Kam thënë, se jam shumë i lumtur që u bë një teatër tjetër me 2 salla. E ka thënë Bujar Asqeriu shumë bukur: “Sa më shumë teatro e galeri, aq më pak burgje.”

Përsëri them se shumë mirë që u bë. Është një teatër, por jo dinjitoz për të qenë Teatër Kombëtar, sipas parametrave teknikë. Të mos u hyjmë parametrave teknikë! Megjithatë, jam shumë i lumtur që u bë dhe e kam përshëndetur.

Eduard Shalsi – Ju falënderoj për përgjigjen!

Kam një pyetje për arkitektin Merxhani. A e keni lexuar raportin e Institutit?

Pyetja e dytë: A mendoni se duke u rikonstruktuar ai mund të shërbejë si teatër, ndërkohë që ai nuk është iniciuar si godinë për teatër?

Kreshnik Merxhani – Faleminderit!

Eduard Shalsi – Meqë u prezantuan të gjithë, duhet thënë se ju jeni arkitekt i pavarur, nuk jeni i punësuar?

Kreshnik Merxhani – Po, unë s’jam rrogëtar. Është bërë një kërkesë jo më shumë se para 1 muaji me mbi 750 firma, i bazuar në dy nene të ligjit për trashëgiminë kulturore, nenin 25 dhe nenin 32, ku thuhet se përdoruesit, pronarët ose një institucion i specializuar, mund të propozojnë shpalljen e një objekti sipas një relacioni të shkurtër për monumentet...

Eduard Shalsi – Më falni zoti Merxhani! Ju kam drejtuar 2 pyetje. Pastaj te kjo që doni të dilni...

Kreshnik Merxhani – Më duhet të bëj një korrigjim.

Eduard Shalsi – Më falni, zoti Merxhani!

Do ta bëni korrigjimin. Ju kam drejtuar 2 pyetje. Pasi t’u përgjigjeni pyetjeve, mund të bëni edhe sqarimin. Nuk ju pengon njeri. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merre pa emocion!

Kreshnik Merxhani – Po më privoni pak. Po duroj.

Eduard Shalsi – Për çfarë po duroni?

Kreshnik Merxhani – Po e duroj virusin dhe po e mbaj.

Kërkesa e dytë është bërë në planin e përgjithshëm vendor nga studio “Torezi”, nga studio “Boeri” për ta shpallur monument kulture.

Eduard Shalsi – Dakord, e mora vesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po keqkuptohemi tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ia jap fjalën, por duhet ta kuptojë pyetjen, se ai e keqkuptoi dhe ju e intimiduat. Edhe një herë, pyetja është: A e keni lexuar raportin e Institutit? Përgjigjuni me po apo me jo! Nëse e keni lexuar, çfarë mendimi keni. Nëse nuk e keni lexuar, nuk ka përgjigje.

Kreshnik Merxhani – Raporti nuk është publik në faqen zyrtare. Çdolloj raporti të kem lexuar, nuk e besoj, sepse nuk është bërë publik në faqen zyrtare.

Eduard Shalsi – Dakord.

Kreshnik Merxhani - Kjo është përgjigja. Ata janë të detyruar ta bëjnë publik raportin e tyre. Cila ishte pyetja e dytë?

Eduard Shalsi – U zgjatëm shumë. Kaq e thjeshtë ishte.

Pyetja e dytë: Ai është një objekt që nuk është dizenuar kur është iniciuar për t'u ndërtuar për teatër.

Kreshnik Merxhani – Nuk më rezulton kështu.

Eduard Shalsi – Ta mbaroj dhe ju lutem, pa emocion!

Kreshnik Merxhani – Duhet pak emocion.

Eduard Shalsi – E kisha fjalën për emocion pozitiv.

Edhe një herë! Do t'ju jap të gjithë kohën e mjaftueshme për t'u përgjigjur, se nuk kam asnjë problem. Pra, mendoni se duke u rikonstruktuar ato mjedise aktuale mund të shërbejnë si teatër, ndërkohë që ai është një objekt që nuk është dizenuar kur është iniciuar për t'u ndërtuar për teatër, 100 vjet më parë. A mendoni se ato mjedise aktuale a mund të shërbejnë për të pasur një Teatër Kombëtar dinjitoz? Në cilat eksperiencë jeni konsultuar për hapësirat e teatrit dhe si i keni krahasuar ato me objektin konkret?

Kreshnik Merxhani – Duhet të kuptojmë një gjë. e para, këtu po flasim a të ruhet apo të mos ruhet. Për sa i përket historisë, rezulton që ka pasur sallë teatri. Ka disa fotografi të publikuara së fundmi. Plus kësaj, është edhe projekti dhe libri i famshëm i Politeknikut të Barit, i cili ka konsultuar Arkivin Teknik të Institutit të Ndërtimit, ku rezulton të ketë pasur sallë teatri.

Pavarësisht kësaj, një individ si unë, meqenëse që e thamë që jam individ, nuk mund të marrë kurrësi përsipër ato analiza që ju më kërkua, që të analizoj të gjitha sallat e kështu me

radhë. Ajo që ne kërkojmë si qytetarë dhe si profesionistë në radhë të parë, është t'i jepet mundësia Teatrit Kombëtar të pranojë një alternativë për ta restauruar dhe një konkurs ndërkombëtar, i cili i analizon të gjitha parametrat që ka dhe çfarë duhet të ketë një Teatër Kombëtar, projektin e detyrës që duhet ta hartojnë mirë ministrinë dhe duhet të vënë si kryeradhë ruajtjen e tij dhe së fundi, të japë alternativat se si mund të ruhet.

Nga ana tjetër, ne, në paletën e gjerë të profesionit dhe në kurrikulën universitare kemi lëndë, si Restaurimi, Adaptimi Arkitektonik, Rigjenerimi Urban dhe Arkitektura e Peizazhit. Pra, këto lëndë marrin përsipër me një kurrikul të plotë ta kurojnë, ta rijetëzojnë dhe ta rikuperojnë situatën te Teatri Kombëtar.

Pra, përveç Restaurimit kemi lëndë për adaptimin që do të thotë, se postulati i arkitekturës moderne nisi me format mbi funksionin, ndërsa postmodernia nisi duke parë aftësinë e objekteve në kohë, kur një kishë ose një tempull, kthehej në kishë dhe një kishë në xhami dhe një xhami kthehej (në kohën e komunizmit) në teatër, në cirk e kështu me radhë, pa fuqinë e formës për të pranuar shumë funksione brenda saj.

Është edhe postulati i Aldo Rosit, që thotë: “Funksioni ndjek formën.” Aty është gjithë mundësia që forma t'i japë hapësirë funksionit për ta ndjekur.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Suli më pas ju dhe zoti Shehaj që kishte për të bërë komentin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Suli ka një orë që ka kërkuar fjalën.

Rakip Suli - Faleminderit, zoti kryetar!

Kam respekt të veçantë për të gjithë panelin, veçanërisht për aktorët që normalisht kanë një lidhje shpirtërore me Teatrin.

Kam një pyetje të drejtpërdrejtë për zotin Bojaxhi, duke marrë shkas nga pyetja e zotit Shalsi. Ai tha se ka 7 vjet që drejton këtë institut.

Gjergj Bojaxhi – Jo nuk thashë se e drejtoj, por thashë se jam anëtar.

Rakip Suli – Dakord.

Vazhdoni edhe sot të jenë pjesë e subjektit politik, ku keni qenë deri para pak kohësh?

Pyetja e dytë: duke marrë shkas nga pyetja e zotit Mima, i cili pyeti për Piramidën, a ju ka shqetësuar investimi prej 3 milionë eurosh, që është bërë në kohën e PD-së te Piramida, ku

është faktore edhe një pjesë e maxhorancës, që nuk ka kërkuar llogari për këtë investim prej 3 milionë eurosh atje?

Nëse keni informacion, mund t'i japësh përgjigje edhe zotit Mima.

Eduard Shalsi – Shkurt, ju lutem!

Gjergj Bojaxhi – Patjetër. Ju falënderoj për pyetjet!

Mendoj se të gjithë si qytetarë, jemi njerëz jonjëdimensionalë, kështu përpiqemi të angazhohemi dhe të japim kontributin tonë në shumë drejtime të ndryshme të shoqërisë. Mendoj se kjo duhet të jetë një vlerë për të gjithë ne dhe të mos quhet sikur është diçka e keqe. Kjo ishte përgjigja e pyetjes së parë.

Në lidhje me pyetjen e dytë, unë mendoj se çdo shpenzim i hedhur në objektet e monumenteve të kulturës, i cili është bërë pa u menduar nga çdolloj qeverie, edhe nga qeveria e mëparshme, siç e përmendët edhe ju, duhet të dënohet, sepse në fund ato janë lekët e taksapaguesve shqiptarë dhe duhet të përdoren me kujdes.

Besoj se të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që, në qoftë se në këtë vend do të dominonte profesionalizmi dhe jo militantizmi, konkurrenca e drejtë dhe jo patronazhi e pazaret e tenderëve, ne do të kishim lekë dhe fonde për të bërë me dhjetëra teatro të rinj kombëtarë në Tiranë dhe në rrethe.

Eduard Shalsi – Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Megjithëse zotit Bojaxhiu iu çor maska, më lejoni edhe mua të bëj pyetje.

Eduard Shalsi – Si?

Edmond Spaho – Ia çorët maskën dhe mund të jetë i demoralizuar...

Zoti Bojaxhiu, meqenëse ju jeni pjesë e një organizmi që merret me trashëgiminë kulturore të Tiranës, e Forumit për Trashëgiminë Kulturore, dhe duke marrë shkas nga pyetja e kryetarit të komisionit, a jeni në dijeni që ky kompleks, ku bën pjesë edhe Teatri Kombëtar, është ndërtuar si rrethi kulturor italo-shqiptar “Skënderbeg”; godina, për të cilën ne po diskutojmë, e ka pasur emërtimin “teatër-kinema”?

E dyta, a është ky kompleks pjesë e të gjitha ndërtimeve që u bënë në atë kohë, një pjesë e të cilave përfunduan në vitin 1940 dhe një pjesë tjetër mbetën të papërfunduar dhe u vazhduan gjatë viteve të para të diktaturës?

Pra, a është ky kompleks që po diskutojmë pjesë e kompleksit më të madh që ka filluar që nga ish-bashkia e qytetit që përfundonte tek universiteti; a ka qenë pjesë integrale, unike?

Gjergj Bojaxhi – Po, zoti Spaho, është e vërtetë që ky objekt ka qenë pjesë e një kompleksi më të madh kulturor dhe administrativ që u ndërtua për t'i dhënë Tiranës një identitet europian. Në fakt, puna për këtë objekt nuk ka filluar në kohën e fashizmit italian, por në kohën e mbretërisë. Në vitin '38 kanë filluar shpronësimet e para. Një nga familjet që është shpronësuar për të bërë këtë objekt është familja Libohova, e cila ka qenë një nga familjet më të pasura në atë kohë në Shqipëri.

Ironia është që dikur shteti i ri shqiptar kishte këllqe që me anë të shpronësimeve t'ua merrte privatëve tokën për interesa dhe funksione publike, ndërsa shteti 105-vjeçar shqiptar jo vetëm që nuk ka këllqe t'ua marrë, por po ua jep dhe kjo, në njëfarë mënyrë, nuk është një gjë e mirë dhe nuk është një shembull i mirë.

Për sa i takon kompleksit, ai ka qenë i ideuar për të qenë edhe teatër, edhe kinema dhe, siç e tha edhe arkitekti, ka godina të cilat arrijnë të përshtaten në kohë dhe të luajnë shumë funksione. Normalisht, godina të tilla kanë më shumë vlerë në shoqërinë ku ekzistojnë dhe përdoren.

Ju faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Agron Shehaj – Në fakt, nuk ishte synimi im t'ju ofendoja, zoti inxhinier, në asnjë mënyrë. Në qoftë se u ofenduat, ju kërkoi ndjesë! Thjesht ishte një mënyrë për të shprehur habinë time për konkluzionet në të cilat ju kishit arritur. Në fakt, mendoj se duhet të jenë anëtarët e këtij komisioni që duhet të ndihen të ofenduar me argumentet që ju sollët. Unë mendoj se në asnjë vend të botës nuk do të jepej një konkluzion i tillë, pra të priset një monument dhe një ndërtesë si Teatri Kombëtar, aq më tepër me argumente të llojit që nuk ka banja të mjaftueshme, nuk ka dhoma zhveshjeje, nuk ka sistem ajrim-kondicionimi. Ajo ishte një mënyrë që unë përdora për të shprehur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kupton ti më shumë... E ke treguar ti si ministër i Shëndetësisë që kupton më shumë...

E përsëris që ne duhet të ndihemi të ofenduar. Me vjen keq të vë në diskutim aftësinë tuaj profesionale, zotëri, por e kam vërtetë të vështirë të kuptoj se çfarë ju shtyn ju të vini në këtë komision me këto konkluzione! Kështu që...

Agron Hysenbelliu – Unë kam sjellë një aktekspertizë.

Agron Shehaj – Kush tha ligj?! Unë nuk thashë ligj, por konkluzione...

Agron Hysenbelliu – Të lutem, se unë nuk ofendova njeri, por kam firmosur si 11 të tjerët. Nuk thashë të priset, por thashë që nuk bëhet. Ja ku e ke aktekspertizën, lexoje! Aty nuk thuhet të priset, por që është e pabanueshme dhe nuk rikonstruktohet.

Agron Shehaj – Çfarë do të thotë që nuk rikonstruktohet?

Eduard Shalsi – Ju lutem, fiken mikrofonin! Mos bëni asnjë ndërhyrje! A mbaruat?

Në rregull, dua të them dy fjalë, sepse sinqerisht gjatë kësaj periudhe kohore jam ndier i shtëllidur, sidomos kur filloi të politizohej çështja e Teatrit. Unë mendoja se debati do të ishte profesional, teknik. Për shembull, nuk bie dakord me disa gjëra që tha arkitekti, por kjo nuk më pengon që të ulem e të diskutoj. Teksa procesi është politizuar, dëmi ka qenë i jashtëzakonshëm. Për më tepër, edhe pjesa e komunikimit ka kaluar deri në disa fyerje që nuk na nderojnë as ne, por as komunitetin e artistëve. Sfidë kanë qenë: çfarë duam, pra nëse duam një teatër kombëtar modern sipas parametrave kohorë, apo duam të mbajmë në këmbë një ngrehinë, të cilën askush deri më sot nuk e ka klasifikuar si godinë të rëndësisë së veçantë për t'u mbrojtur? Sinqerisht do të kisha reflektuar sikur të kisha gjetur gjurmë, siç kam gjetur gjurmë për shtëpi karakteristike, për godina karakteristike apo për monumente kulturore nga individë, shoqata apo institucione. Më duket paradoksale dhe nuk është argument fakti që “nuk na shkonte ndër mend”.

Për të gjitha objektet që do të prisen u ka shkuar ndër mend? Jo! Në këtë vend ka pasur individë të shqetësuar, me argumente apo pa argumente dhe kjo lë shteg për t'u interpretuar. Por po pyesja veten gjatë gjithë kësaj kohe, gjithë këta meraklinj të mëdhenj, këta kujdestarë (nuk po flas për ata që kanë qenë në pushtet, se është një paradoks më vete të kesh qenë 8 vjet në pushtet, në ekzekutiv dhe të mos kesh lënë një gjurmë të vetme tek teatri; të mos kesh lënë një gjurmë të vetme qoftë edhe në aspektin legjislativ), tani dalin partizanë për të mbrojtur diçka! Kjo pjesë e ka dëmtuar. Ka qenë debat çështja e konkursit, pra se si do të trajtohet, por të gjitha këto janë ezauruar. Vizioni është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mbaruat? Bëtë pyetje, diskutime, debate. Kam folur më pak...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ora është 18:50, kemi filluar në orën 16:00 dhe, përveçse kam dhënë fjalën, nuk kam ndërprerë asnjërin prej jush. Nëse do të vazhdoni kështu, nuk më mbetet gjë tjetër vetëm të

falënderoj të ftuarit. Shumë faleminderit që keni qenë të pranishëm! Na lejoni të vazhdojmë me axhendën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevis Balliu – Kalojmë te diskutimet! Pse nuk kalojmë te diskutimet?

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Kalojmë në diskutimin nen për nen!

Duke falënderuar të ftuarit dhe të gjithë kolegët e maxhorancës e të opozitës për debatin dhe për kontributin, sepse, së paku, sot debati ishte konstruktiv, pavarësisht se ndajmë pikëpamje të ndryshme, të kundërta!

Kalojmë te diskutimi dhe votimi nen për nen.

Neni 1, sipas variantit të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2, sipas variantit të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3, sipas variantit të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Këtu ka një sugjerim për teknikë legjislative: të numërtohen paragrafët e nenit 4.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime: në pikën 1, pas germës “d” të shtohet germa “dh” me përmbajtjen si vijon: “trupa teatrore”; pika 3 riformulohet si vijon: “Trupa teatror përfaqësohet në komisionin e negocimit me jo më shumë se dy përfaqësues të përzgjedhur nga ata vetë”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Në nenin 6 bëhen këto ndryshime: pika 1 riformulohet si vijon: “Komisioni i negocimit të kontratës vlerëson dhe negocion me palën private, shoqërinë “Fusha sh.p.k”, propozimin e paraqitur prej tyre dhe harton projektkontratën finale të negociuar nga palët,

shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave brenda një afati kohor prej 30 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të VKM-së për krijimin e komisionit”. Në pikën 3 shprehja “partner privat” të zëvendësohet me “palë private”. Pika 4 konsiderohet e tepër dhe hiqet.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7. Në nenin 7 bëhen këto ndryshime: në pikën 5 shprehja “pronari- shtet, Bashkia Tiranë”, të zëvendësohet me shprehjen “Bashkia Tiranë”. Në pikën 6, në fund të fjalisë shtohet shprehja “sipas rregullave të përcaktuara në VKM-në e ngritjes së komisionit të negocimit”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8. Në pikën 2 të nenit 8, germa “h”, shprehja “principet komerciale” të zëvendësohet me shprehjen “parimet tregtare” dhe në germën “gj”, pas fjalës “ndjekur” të shtohet fjala “mbikëqyrur”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9, sipas variantit të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10, sipas variantit të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11 riformulohet: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në mbështetje të nenit 5, pika 2, të këtij ligji, jo më vonë se 45 ditë nga hyrja e tij në fuqi. Propozohet heqja e nenit 7, pika 3, pasi vendimi që do të miratohet sipas këtij neni është i njëjtë me atë që do të miratohet pas nenit 5, pika 2.”

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12, sipas variantit të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Komisioni i Ligjeve ka propozuar që kudo në tekst shprehja “partneri privati” të zëvendësohet me shprehjen “palë private”. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Edhe një herë, falënderoj shumë të gjithë kolegët!

Shihemi nesër!

MBYLLET MBLEDHJA